



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE**

Nr. 32/29 Prot.

Tiranë më, 30.05.2024

V E N D I M

Nr. 30 datë 30.05.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Loreta Hanxhari	Kryesuese
Bora Vrenjo	Relatore
Henri Naqellari	Anëtar

asistuar nga anëtarja e Sekretariatit Teknik Znj. Lediana Azemaj, në datën 17.05.2024, ora 11:00, në Sallën e Mbledhjeve, kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT: **Z. Dhimitraq Jorgaq Ziu** me funksion Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër.

OBJEKTI: **Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 12/2018** “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, (këtu e në vijim Ligji nr. 12/2018, i ndryshuar).

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi dhe vlerësoi shpjegimet dhe argumentimin ligjor të Relatorit të çështjes, Znj.Bora Vrenjo; shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar si edhe dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni përgjegjës për kryerjen e procesit të vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, bazuar në Ligjin nr.12/2018, *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, i ndryshuar.
2. Subjekti i vlerësimit kalimtar, Dhimitraq Jorgaq Ziu, ka dorëzuar *deklaratën e pasurisë, deklaratën e kontrollit të figurës dhe formularin e vlerësimit të aftësive profesionale*, për funksionin Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër, sipas përcaktimeve të neneve 32, pika 2, 36 pika 1, dhe 44 pika 1, të Ligjit Nr.12/2018, *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, i ndryshuar.
3. Bazuar në nenin 6 të Ligjit nr.12/2018 *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, i ndryshuar, Dhimitraq Ziu është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër.
4. Subjekti i vlerësimit, Dhimitraq Ziu, iu nënshtrua procedurës së shortimit, në shortin e zhvilluar në datën 05.04.2023, nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.07 datë 17.01.2023 *“Për Procedurat dhe Mënyrat e Hedhjes së Shortit për Trupat e Vlerësimit dhe Subjektet e Vlerësimit të Ligjit 12/2018, i ndryshuar”*. Sipas shortit të zhvilluar, Trupa e Vlerësimit përbëhet nga Znj. Loreta Hanxhari (Kryesuese); Znj.Bora Vrenjo (Relatore) dhe Z. Henri Naqellari (Anëtar).
5. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit, sipas nenit 27, pika 1 të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar dhe neneve 30 dhe 31, të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr. 197, datë. 28. 02. 2023 *“Për hapat proceduralë të unifikuar”*, vendosi me Vendimin nr.1 datë 18.04.2023, fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Dhimitraq Ziu si dhe të caktojë Kryesues të Trupës Vlerësuese Znj. Loreta Hanxhari.
7. Relatori i çështjes, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar të datës 18.04.2023, njoftoi subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar duke i bërë të njohur përbërjen e Trupës së Vlerësimit dhe duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
8. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, “Deklaratën për Konfliktin e Interesit” me nr. *** prot. , datë 19.04.2023, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
9. Relatori i çështjes, në përmbushje të detyrave ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, dhe sipas:
 - nenit 7, pika 1, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023 *“Për hapat proceduralë të unifikuar”*, nenit 4, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 19.04.2023 , pranë ILDKPKI-së, formularin e deklarimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit .
 - nenit 7, pika 7, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023 *“Për hapat proceduralë të unifikuar”*, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 19.04.2023, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, formularin e aftësive profesionale për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
 - nenit 7, pika 4, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023 *“Për hapat proceduralë të unifikuar”*, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 19.04.2023, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, deklaratën e kontrollit të figurës për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
10. Bazuar në nenin 34, pika 3, nenin 42, pika 1 dhe nenin 46, pika 2, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar janë administruar raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (në vijim AMP) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (në vijim DPPSH). Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.
11. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.

12. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, Trupa e Vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.

13. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit nr.12/2018 (i ndryshuar) ka për objekt:

- a) *vlerësimin e pasurisë;*
- b) *kontrollin e figurës;*
- c) *vlerësimin e aftësive profesionale.*

14. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:

- a) Ligjin nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
- b) Ligjin nr.128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.
- c) Ligjin nr.40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”.
- d) Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”.
- e) Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm, nr.7, datë 17.01.2023, “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”.
- f) Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe ILDKPKI nr. 15, datë 27.01.2023, “Për miratimin e formularëve të deklarimit të Pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar.
- g) Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat proceduralë të unifikuar”.

Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

- *Deklarata e Pasurisë,*
- *Deklarata për Kontrollin e Figurës*
- *Formulari i Vlerësimit Profesional*
- *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet,*
- *Tri raportet ndihmëse të hartuara nga institucionet shtetërore;*
- *Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.*
- *Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.*

- *Ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.*

15. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 12 dhe 14, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar, nenit 3, pika 11 dhe nenit 5, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

16. Me subjektin e vlerësimit, është komunikuar me anë të postës elektronike duke i bërë pyetje dhe kërkuar sqarime, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave.

17. Trupa e Vlerësimit, pasi dëgjoi relatimin e bërë nga relatorja e çështjes dhe studioi materialin e përgatitur për këtë qëllim, krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kanë nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatuan se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Dhimitraq Ziu, me Vendimin nr. 2, datë 02.05.2024, vendosi :

a) Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Dhimitraq Ziu;

b) Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:

- *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht dhe*
- *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*

c) Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47, të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 5 ditësh për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

18. Subjekti i vlerësimit, pas njoftimit me e-mail datë 02.05.2024 , mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Trupa Vlerësuese, e ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve duke dhënë sqarime mbi disa gjetje të pasqyruara në relacion. Sqarimet e paraqitura së bashku me dokumentacionin shoqërues, pasi u administruan, u analizuan dhe u pasqyruan në relacionin përfundimtar.

II. SEANCA DËGJIMORE

19. Subjekti i vlerësimit, Dhimitraq Ziu, u ftua në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 17.05.2024, ora 11:00 në adresën: Salla e Mbledhjeve Kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme.

20. Seanca dëgjimore me subjektin, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, në datën dhe adresën e përcaktuar.

21. Subjekti i vlerësimit, gjatë seancës dëgjimore mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i vlerësimit Dhimitraq Ziu kërkoi nga Trupa Vlerësuese konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

22. Subjekti i vlerësimit, Z. Dhimitraq Ziu, ka qenë bashkëpunues në procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikmëri afatet e përcaktuara nga Trupa Vlerësuese, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. ARSYETIMI LIGJOR I TRUPËS SË VLERËSIMIT

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Në bazë të nenit 32, pika 1, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, punonjësi deklaroi çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar që nga data e fillimit të marrëdhënies së punës në institucionin përkatës, pavarësisht datës së emërimit në pozicionin dhe/ose gradën që mban, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë.
24. Trupa e Vlerësimit ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe fakt, për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për punonjësën dhe për personat e lidhur me të, të parashikuar në nenin 31, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
25. Deklarimi i pasurisë nga subjekti kryhet sipas parashikimeve të nenit 32 e 33, ndërsa procedura e vlerësimit të pasurisë nga Trupa e Vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar.
26. Sipas kreut III, neni 33/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ILDKPKI-ja bazuar në deklaratimet e pasurisë, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli dhe në përfundim përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.
27. Hetimi administrativ i Trupës Vlerësuese pasi administroi dhe u njoh me Raportin e ILDKPKI-së, konsistoi në:

-verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;

- në verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruar si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të deklaruar;

- në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

28. Trupa e Vlerësimit për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë, ka thelluar hetimin nëpërmjet:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së pasurisë së vlerësimit kalimtar;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhat përkatëse, në raport me të dhënat në deklaratën e vlerësimit kalimtar;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jo financiare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve – gjendje cash;
- d) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetë deklaruara nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar.

29. Trupa e Vlerësimit i ka vlerësuar këto deklarime së bashku me provat e tjera në tërësi dhe harmoni me të gjitha rrethanat e çështjes.

30. Subjekti i vlerësimit Z. Dhimitraq Ziu ka plotësuar dhe dorëzuar deklaratën e pasurisë dhe dokumentacion justifikues për të justifikuar vërtetësinë e deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, në zbatim të nenit 32, pika 2, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

31. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33/1, pika 3 e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka konstatuar se:

- a) Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
- b) nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

DEKLARIMI I PASURIVE NGA SUBJEKTI I VLERËSIMIT

Pasuria 1

- Apartament banimi me sip. 94 m2, me adresë në Berat, blerë në vitin 1994 nga NK Banesa Berat, nr. Pasurie***, vlera 33.810 Lekë. Burimi i krijimit: Kursimet e familjes 1994.
- Blerje e pjesës takuese të pandarë të prindërve, të banesës me sip. 94 m2 që ndodhet në lagjen Berat. Me kontratë noteriale në vitin 2003. Burimi i krijimit: Të ardhurat nga pagat 1986-2003. Të ardhurat nga qiratë sipas kontratës 1999-2003. Vlera: 200.000 Lekë.
- Njësi tregtare me Sip. 13.7 m2, ndodhur në Berat, regjistruar në emrin tim dhe bashkëshortes. Vlera 10.000 Lekë. Pjesa takuese 50/50%.

- Njësi tregtare me sip. 14.8 m², ndodhur në Berat, regjistruar në emrin tim dhe të bahkëshortes. Vlera 10.000 Lekë. Pjesa takuese 50/50%. Burimi i krijimit: Nga adaptimi i një dhome të apartamentit të përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore, rivlerësuar pasuria në vitin 2012. Pjesa takuese 50/50%.

Dokumentacioni bashkëlidhur:

- Kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme nr. ***rep., nr. ***kol., datë 19.04.1994, me palë shitëse NK Banesa Berat dhe palë blerëse Dhimitraq Ziu, Drita Ziu, Jorgaq Ziu, Evgjeni Ziu, të një apartamenti të përbërë nga 3 dhoma + 1 kuzhinë. Shuma e likujduar në vlerën 33.810 Lekë.
- Kontratë shitblerje e pasurisë së paluajtshme nr. ***rep. , nr. ***kol., datë 27.05.2003, palë shitëse Jorgaq Ziu, Evgjeni Ziu dhe palë blerëse Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu të pjesës takuese zotëruese nga pala shitëse të apartamentit të regjistruar me nr. Pasurie****, sip. Totale 94 m², në bashkëpronësi të palëve. Shitësat deklarojnë se i shesin palës blerëse tërësisht pjesët e tyre takuese të pa ndara mbi apartamentin, kundrejt vlerës 200.000 lekë. Gjithashtu pala blerëse deklaron se janë dakord të blejnë tërësisht pjesët takuese të pa ndara të shitësve, se e kanë aktualisht në përdorim dhe se marrin përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo pronësi.
- Kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme nr. 621 rep., nr 236 kol., datë 24.02.2005 nënshkruar ndërmjet palës shitëse Dhimitraq e Drita Ziu dhe palës blerëse S. Bode të pasurisë së paluajtshme nr. 15/71+1-1/1, lloji “njësi”, me sip. totale 65.5 m², ndodhur në lagjen “30 vjetori”, Berat. Çmimi i shitjes 1.000.000 lekë, është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale. B/lidhur dokumentacioni ligjor i pasurisë nr. 15/71+1-1/1, regjistruar në emër të Dhimitraq Ziu e Drita Ziu, datë 08.02.2005.
- Vërtetim nga dokumentet hipotekor, date 14. 11.2003 të cilën figuron e regjistruar pasuria nr. ****me sip. 66 m², në emër të Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu. Data e lëshimit të vërtetimit 14.11.2003.
- Vërtetim nga dokument hipotekor, datë 14.11.2003 në të cilën figuron e regjistruar pasuria me nr. ****me sip. 66 m², në emër të Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu, ndodhur në, Berat.
- Leje ndërtimi nr.***, lëshuar nga KRRT Bashkia Berat, ku sipas Vendimit nr.***, datë 21.06.2002, i jepet leje subjektit ndërtues “AMA” për adaptim banese, objekti:lokal në, Berat, ndodhur në katin përdhe të pallatit 5 katësh, nr.**.
- Akt shfrytëzimi datë 17.07.2003 nga Seksioni i Urbanistikës, Bashkia Berat, për lejen e ndërtimit nr.***, datë 28.11.2002, financues Dhimitraq Ziu. Vendim KRRT nr. ***datë 21.06.2002.
- Procesverbal kolaudimi të objektit “Adaptim banese e Z. Dhimitraq Ziu” sipas së cilit puna filloi më 22.04.2003 dhe përfundoi në 23.04.2003. Dy dritare janë adaptuar në dyer, pa ndryshuar hapësirën e dritares ekzistuese, pa ndryshuar lartësinë e dritares, nuk është

ndërhyrë në konstruksionin mbajtës. Muret nuk janë prekur. Janë kryer vetëm këto punime: Vendim KRRT nr. **datë 21.06.2002.

- Proces Verbal kolaudimi të objektit “Adaptim banese e Z. Dhimitraq Ziu” sipas së cilit puna filloi më 22.04.2003 dhe përfundoi më 23.04.2003. Dy dritare janë adaptuar në dyer, pa ndryshuar hapsirën e dritares ekzistuese, pa ndryshuar lartësinë e dritares, nuk është ndërhyrë në konstruksionin mbajtës. Muret nuk janë prekur. Janë kryer vetëm këto punime: “vendosje qepenash llamarine, 5m2 x 4.000 lekë”. Situacioni përfundimtar 20.000 lekë. Zbatues: AMA shpk.
- Akt kontrolli.
- Certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë njësi me sip. 13.7 m2, regjistruar në emër të Dhimitraq Ziu, me nr.***, ndodhur në Berat. Data e lëshimit të certifikatës 15.02.2012. B/lidhur:
 - Kartela e pasurisë së paluajtshme, në të cilën evidentohet rivlerësimi i pasurisë, datë 09.02.2012, në vlerën 2.000.000 Lekë. Harta treguese e pasurisë.
 - Vërtetim nga dokumentet hipotekore ku figuron e regjistruar pasuria me sip. 13 m2, nr.****, në emër të Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu. Data e lëshimit të vërtetimit 14.11.2003. B/lidhur kartela e pasurisë dhe planimetria e pasurisë.
- Certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë njësi me sip. 14.8 m2, regjistruar në emër të Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu, me Nr.***, ndodhur në Berat . Data e lëshimit të certifikatës 15.02.2012. B/lidhur:
 - Kartela e pasurisë së paluajtshme në të cilën evidentohet rivlerësimi i pasurisë në datën 09.02.2023, në vlerën 2.000.000 Lekë.
 - Harta treguese e pasurisë.
 - Vërtetim nga dokumentet hipotekore, ku figuron e regjistruar pasuria me sip. 15 m2, nr.*****, në emër të Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu. Data e lëshimit të vërtetimit 14.11.2003. B/lidhur kartela e pasurisë së paluajtshme dhe planimetria e pasurisë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

Nga korespondenca me institucionet ligjzbatuese, është administruar dokumentacioni përkatës. Në lidhje me ekzistencën e pasurisë së paluajtshme, nga hetimi administrativ ka rezultuar:

- **ASHK online**, konfirmon pasurinë ***** në emër të Dhimitraq Ziu, Drita Koli, status “mbyllur”. Ndërkohë, konfirmon pasuritë aktive, nr. *** dhe nr. *** në emër të Dhimitraq Ziu, Drita Ziu, status “aktive”.
- **ASHK Berat**, me shkresën nr. *** prot., datë 22.06.2023, konfirmon pasuritë “Njësi” e regjistruar me sip. 13.7 m2, nr*****dhe sip. 14.8 m2, nr. *****në emër të Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu, ZK***. Bashkëlidhur ndodhet dokumentacioni i pronësisë së kësaj pasurie, i cili përmban:

- Kartelën e pasurisë nr.****, njësi dhe sip. 14.8 m2, nr. ****në emër të Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu. Adresa e pasurisë në Berat, regjistruar në datë 14.11.2003, rivlerësuar në datë 09.02.2012, në vlerën 2.000.000 Lekë.
 - Kartelën e pasurisë nr.****, njësi me sip. 14.8 m2, regjistruar në emër të Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu. Adresa e pasurisë në Berat, regjistruar në datë 14.11.2003.
 - Planimetria dhe plani i rilevimit të pasurisë****, dt. 4.11.2004.
 - Vërtetim nga dokumentet hipotekore, datë 14.11.2003, në të cilin figuron e regjistruar pasuria me sip. 66 m2, në emër të Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu. Data e lëshimit të vërtetimit 14.11.2003.
- **Subjekti sqaron:** se në momentin që është shitur pasuria “njësi” prej 66 m2, ndryshimi i destinacionit të pasurisë ishte kryer më parë, kjo referuar praktikës që ka paraqitur për dy njësitë. Në të njëjtin aplikim është kryer ndryshimi i sipërfaqeve të apartamentit, duke përfituar tre njësi të ndryshme. Numri i pasurisë ****dhe ****janë e njëjta gjë dhe ndryshimi vjen si pasojë e lapsusit të regjistrimit në hipotekë, pasi përveç destinacionit të pasurisë nga apartament në njësi, nuk janë bërë ndryshime të tjera në pasuri. Gjithashtu edhe sipërfaqet e përcaktuara lidhen me specifikimet e vendosura në hipotekë. Faktikisht vlera e saktë është 66 m2. Në mënyrë të përmblodhur subjekti sqaroi se: Në datë 14.11.2003 ka kërkuar ndarjen e pasurisë në tre ambiente, ku është pajisur në tre vërtetime hipotekore:

1. Pasuri “Apartament” Nr. ****me sip. 66 m2.
2. Pasuri “Njësi” nr.****, me sip. 13 m2.
3. Pasuri “Njësi” nr.****,me sip. 15 m2.

Në nëntor 2004 ka kryer plan Rilevimi dhe ndryshimin e destinacionit, ku pas këtij aplikimi janë bërë ndryshimet:

1. Pasuri “Njësi” nr.****, me sip. 65.5 m2 (shitur në vitin 2005).
2. Pasuri “Njësi” me nr.****, me sip. 13.7 m2.
3. Pasuri “Njësi” me nr.****, me sip. 14.8 m2.

Likuidimi i apartamentit të shitur është kryer cash dhe nuk disponon mandate arkëtimi. Tatim fitimi i paguar për shitjen e apartamentit është në vlerën 5000 lekë. Subjekti sqaroi se adaptimi i apartamentit konsiston vetëm në ndryshimin e dritareve të tij në dyer, duke qenë se apartamenti ndodhet në katin përdhe. Kjo e vërtetuar edhe nga procesverbali i kolaudit të objektit, në të cilin shprehimisht është përcaktuar se dritaret janë adaptuar pa ndryshuar në lartësi dhe janë kryer punime vendosje qepenash, për vërtetimin e të cilave do të vë në dispozicion foto të tyre. Këto janë të vetmet ndryshime të kryera prej tij. Çdo ndryshim tjetër i kryer nga qiramarrësit, është kryer nga vetë ata në bazë të funksionit që zhvillojnë. Dokumentacioni që ka paraqitur lidhur me përshtatjen e njërive në hipotekë, është i vetmi që disponon. Shuma e shpenzuar gjithsej për dy njësitë, është 39.400 lekë.

Subjekti paraqit dokumentacionin si më poshtë:

- Plan Rilevimi i pasurisë****, datë 04.11.2004.

- *Planimetrinë e banesës/objektit.*
- *Kartelat e pasurive të njësive nr. ****dhe nr. ****, dt. 14.11.2003.*
- *Mandat arkëtimi dt. 24.2.2005 nga ZVRPP Berat të shumës 5.000 lekë për tatimin e fitimit të shitjes së apartamentit në Berat. në vlerën 1.000.000 lekë.*
- *Mandat arkëtimi dt. 25.6.2003 nga ZVRPP Berat të shumës 1.000 lekë për tatimin e fitimit të shitjes së apartamentit në Berat, në vlerën 200.000 lekë.*
- *Formularin e aplikimit dhe llogaritjes për rivlerësim, të pasurisë njësi nr. ****(detyrimi për t'u paguar 19.701 lekë).*
- *Formulari i aplikimit dhe llogaritjes për rivlerësim të pasurisë njësi nr. ****(detyrimi për t'u paguar 19.690 lekë).*
- *Akt vlerësimi nga vlerësuesi i pasurisë.*
- *Fotografi të njësive.*
- **Në proces verbalin e datës 13.10.2023**, subjekti sqaroi se apartamenti në Berat, i cili më pas është shitur, ka qenë i mobiluar me mobileritë e kohës së komunizmit dhe një pjesë te tyre i kanë përdorur për shtëpinë në Poshnje.
- **Me postën elektronike datë 20.10.2023**, subjekti sqaroi lidhur me kontratat e qirasë nr.****, datë 03.04.1999 dhe nr. 941/474, datë 19.07.2002, të cilat janë nënshkruar para ndarjes fizike të apartamentit dhe blerjes së pjesës takuese nga prindërit e tij. Sqaroi se qiraja është dhënë për një dhomë të apartamentit, kthyer në dyqan, kurse tre dhomat e tjera janë përdorur për banim nga familja e tij. Aksesimi në ambientin e lëshuar me qira është kryer nëpërmjet derës ekzistuese të apartamentit e ndarë në dy drejtime. Gjithashtu, kontratat e qirasë në vitet 1999 dhe 2002 (para blerjes së pjesës takuese të prindërve), janë nënshkruar prej tij si palë qiradhënëse me pëlqimin e prindërve, përpara noterit si përfaqësues ligjor.

Bazuar në deklarinë e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

Pasuria apartament me sip. 94 m2 në Berat, është blerë me kontratë privatizimi në vitin 1994 nga subjekti, bashkëshortja dhe prindërit e tij. Në vitin 2003, subjekti dhe bashkëshortja blejnë pjesët takuese të prindërve të subjektit në këtë apartament kundrejt vlerës 200.000 lekë, duke zotëruar të dy së bashku 100% të saj. Më pas, në periudhën 2003-2004, subjekti ndryshon destinacionin e apartamentit duke e ndarë fizikisht dhe juridikisht apartamentin në tre njësi të ndryshme; regjistruar nr. ****me sip. 66 m2; nr. **** me sip. 13.7 m2, dhe nr. **** me sip. 14.8 m2. Në vitin 2005 shet pasurinë nr. ****me sip. 66 m2, kundrejt vlerës 1.000.000 lekë.

Burimi financiar për blerjen e pjesës takuese 200.000 lekë nga prindërit, deklarohet pjesërisht nga pagat prej vitit 1986 si dhe të ardhurat nga qiratë e banesës në Berat për të cilat ka paraqitur kontratat përkatëse (trajtuar te të ardhurat). Pasuritë "Njësi" me sip. 13.7 m2 dhe 14.8 m2, në Berat, janë përshtatur nga subjekti, në mbështetje të Vendimit të KRRT, datë 21.6.2002. lejes së ndërtimit datë 28.11.2002 dhe akt shfrytëzimit dt. 17.7.2003.

Sa më sipër rezulton se subjekti ka paguar për privatizimin, ½ pjesë të vlerës 33.810 lekë.

Në v. 2003 ka blerë pjesët takuese të prindërve në shumën 200.000 lekë. Gjithashtu, sipas proces-verbalit të kolaudimit të objektit, vlera e financuar për përshtatjen e apartamentit në 3 njësi është 20.000 lekë.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me sqarimet e dhëna, dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK, lidhur me apartamentin me sip. 94 m2, në Berat, përfituar nga privatizimi, i cili është përshtatur në 3 njësi me sip. 66.5 m2 (i shitur), 13.7 m2 dhe 14.8 m2.**
- ✓ **Shpenzimet për blerjen e pjesës takuese të prindërve në apartamentin në Berat dhe adaptimin e tij në 3 njësi, janë në vlerën totale prej rreth 237.000 lekë.**

Pasuria nr. 2

Godinë + truall, me sip. 29.6 m2, nr. pasurie ** ndodhur në Berat, ndërtuar në vitin 1998. Vlera 521.600 lekë. Pjesë takuese 50/50%. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga 1986-1997 gjithsej 478.134 lekë, të ardhurat e bashkëshortes 1989-1997 gjithsej 300.568 lekë. Të ardhurat nga bujqësia 1991-1997 gjithsej 600.000 lekë. Rivlerësuar pasuria në vitin 2012.

Dokumentacioni bashkëlidhur:

- Certifikatë regjistrimi pronësie të pasurisë nr.***, godinë me sip, trualli 29.6 m2 dhe ndërtesë 29.6 m2, regjistruar në emër të Dhimitraq Ziu. Adresa e pasurisë, Berat. B/lidhur ndodhet kartela e pasurisë në të cilën evidentohet rivlerësimi i pasurisë në vitin 2012, në vlerën 1.500.000 lekë.
- Kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme nr. ****, date 31.10. 1998, palë shitëse Këshilli i Rrethit Berat, palë blerëse Dhimitraq Ziu. Shteti ka në pronësi të tij një sipërfaqe trualli prej 30 m2, të ndodhur në Berat, në të cilin blerësi Dhimitraq Ziu, në bazë të Vendimit datë 10.5. 1996, të K.RR.I., ka ndërtuar një garazh, shtesë pallati. Përfaqësuesi i shitësit deklaroi se sipërfaqen e truallit ja shet blerësit Dhimitraq Ziu, kundrejt vlerës 21.600 lekë. Kjo shitje bazohet në Kontratën e Shitjes së Truallit, dt. 9.7.1997. Palët deklarojnë se blerësi i ka likuiduar shitësit të gjithë shumën prej 21.600 lekë.
- Vërtetim nga dokumentet hipotekor nr.***, datë 03.03.2000, ku figuron e regjistruar sip. 30 m2, në emër të Dhimitraq Ziu.
- Proces Verbal Kolaudimi (pa datë), objekti "garazh", në pronësi të Dhimitraq Ziu. Vlera e objektit 4.000 Usd.

- Akt kontrolli mbi zbatimin e fazave të punimeve dt. 02.06.1998, sipas së cilës përcaktohet se projekti është zbatuar sipas vendimit të KRRI, nr. ****dhe lejes së ndërtimit dt. 16.01.1998.
- Akt shfytëzimi dt. 30.06. 1998, për objektin e ndodhur në Berat, lloji garazh, vendim KRRT nr.**, datë 10.05.1996, leje ndërtimi nr.****, dt. 16.01.1998. Financues Dhimitraq Ziu, firmë zbatuese "Rohfer".
- Vërtetim nga dokument hipotekor dt. 23.2.2012, ku figuron e regjistruar pasuria garazh me sip. truall 30 m2, regjistruar me nr.**, në emër të Dhimitraq Ziu. Adresa në Berat.
- **Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ**
- ASHK Berat, me shkresën nr. **prot., datë 22.06.2023, konfirmon pasurinë e regjistruar me nr.**, në emër të Dhimitraq Ziu, me sip. 29.6 m2, ZK *** dhe ka bashkëlidhur dokumentacionin e pronësisë së kësaj pasurie, e cila përmban:
- Kartelën e pasurisë nr.**, godinë me sip, truall 29.6 m2 dhe ndërtesë 29.6 m2, regjistruar në emër të Dhimitraq Ziu. Adresa e pasurisë në Berat, regjistruar në dt. 21.02.2012, rivlerësuar po në këtë datë, në vlerën 1.500.000 lekë.
- Formularin e aplikimit për rivlerësim të pasurisë **garazh (detyrimi për t'u paguar 3.700 lekë); akt vlerësimi nga vlerësuesi i pasurisë.
- Vërtetim nga dokumentet hipotekor nr.***, datë 03.03.2000, ku figuron e regjistruar sip. 30 m2, në emër të Dhimitraq Ziu.
- **ASHK online**, konfirmon pasurinë ** "garazh" në emër të Dhimitraq Ziu, me status "aktive".

Në proces verbalin e datës 03.07.2023, subjekti sqaroi se vlera 521.600 lekë përmban shumën 4.000 usd të konvertuar në 500.000 lekë e cila përfaqëson vlerën e shpenzimeve të kryera për ndërtimin e objektit, si dhe vlerën 21.600 lekë për blerjen e truallit. Për rivlerësimin e objektit në vitin 2012 ka paguar 3.700 lekë, sipas mandat arkëtimit të cilin e paraqiti. Gjithashtu paraqiti përlllogaritjen e kryer nga ZVRPP për pagesën e tatimit, si dhe akt vlerësimin e pasurisë së paluajtshme. Nuk disponon dokumentacion për shpenzimet e kryera në vitin 1998, por vetëm proces verbalin e kolaudimit në të cilin është shprehur vlera e investimit në total

Bazuar në deklarin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur si dhe në korrespondencën e administruar, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

Pasuria godinë (garazh) + truall me sip. 29.6 m2 në Berat, është ndërtuar nga subjekti, sipas Vendimit të KRRI, datë 10.05.1996, ku firma ndërtuese është pajisur me lejen e ndërtimit datë 16.01.1998 dhe akt shfytëzimin dt. 30.06.1998. Sipas proces verbalit të kolaudimit të objektit,

vlera e financuar nga subjekti është 4.000 usd. Në dt. 31.10.1998, subjekti përfiton me kontratë shitblerje truallin me sip. 30 m2, kundrejt vlerës 21.600 lekë.

Vlera e deklaruar në total është 521.600 lekë.

- ✓ ***Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar, shpjegimet e dhëna dhe përgjigjen e ASHK. Si burim krijimi janë deklaruar të ardhura familjare në dispozicion deri në v. 1998, konkretisht pagat e subjektit dhe b/shortes, në shumën rreth 778.000 lekë dhe të ardhura nga bujqësia 600.000 lekë.***

Pasuria Nr. 3

Tokë arë + truall, me sip. 700 m2 (200 m2 trualli) në Poshnje, Berat, ku është ndërtuar banesa prej 100 m2. Regjistruar në emrin tim dhe bashkëshortes. Vlera 933.000 lekë. Pjesa takuese 50/50%. Burimi i krijimit: trashëgimi prona e familjes nga përpjestimi vullnetar i pasurisë, ndërtuar para vitit 1980 nga prindërit e mi. Shpenzuar për riparim dhe mirëmbajtje nga kursimet e familjes në vitet 2019 - 2020, gjithsej 933.000 lekë.

Dokumentacioni bashkëlidhur:

- Shkresë kthim përgjigje nr. ***prot., datë 26.8.2020, lëshuar nga ASHK Berat drejtuar shtetasit Dhimitraq Ziu, për kopje reference që administron ky institucion.
Bashkëlidhur:
 - Kontratë pjesëtimi vullnetar nr. ** datë 10.2.2012, nënshkruar mes palëve Jorgaq Ziu, Evgjëni Ziu, Dhimitraq Ziu, Drita Ziu, për pasuritë që kanë në bashkëpronësi të ndodhura në Poshnje të Beratit, ZK ***. Konkretisht, sipas kontratës, Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu marrin në pronësi pasurinë nr.***e llojit tokë arë, truall dhe ndërtesë me sip. totale 700 m2, nga sipërfaqja totale truall 200 m2 dhe nga ky truall ndërtesa zë një sipërfaqe prej 100 m2.
- Certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë Arë + Truall, me sip totale 700 m2, nga e cila truall 200 m2 dhe nga kjo ndërtesë 100 m2, regjistruar në emër të Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu, me nr. ***** ndodhur në Poshnje, Berat. Data e lëshimit të certifikatës 20.02.2012. B/lidhur harta treguese e regjistrimit.
- Certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë Arë + Truall, me sip. totale 700 m2, nga e cila truall 200 m2 dhe nga kjo ndërtesë 100 m2, regjistruar në emër të Jorgaq Ziu me nr.*****, ndodhur në Poshnje, Berat. Data e lëshimit të certifikatës 19.01.2012.
Bashkëlidhur kartela e pasurisë + harta treguese e regjistrimit.
- Autorizim për kryerjen e punimeve të vetëdeklaruar nr.*****, datë 16.09.2019, nga Bashkia Ura Vajgurore, referuar vetëdeklarimit të kryer nga qytetari Dhimitraq Ziu, nr. ****prot., datë 16.09.2019.
- Kontratë nënsipërmarrje datë 20.8.2019, nënshkruar ndërmjet palës porositëse Dhimitraq Ziu dhe palës sipërmarrëse "Ndërpro" shpk., me administrator shtetasin I. S, me qëllim riparimin nga ana e sipërmarrësit të shtëpisë së banimit një kat, në pronën me nr.****, ZK

3032, në emër të porositësit. Porositësi, sipas preventivit, paraqet punimet në shumën 592.887 lekë, afat deri në 30. 11.2019, për të cilin do perfundojnë punimet dhe do të kryhet pagesa.

- Preventiv punimesh nëntor 2019, nga subjekti Ndërpro shpk, vlerë totale 592.887 lekë.
- Faturë tatimore shitje nga Ndërpro për Dhimitraq Ziu, datë 30. 11.2019, punime sipas situacionit, vlera 600.591 lekë.
- Faturë e thjeshtë tatimore nr.**, datë 30. 11.2019, blerës Dhimitraq Ziu, vlerë 60.000 lekë.
- Faturë tatimore shitje për Dhimitraq Ziu, datë 24.12.2020, shërbime të ndryshme, vlerë 50.000 lekë.
- Faturë tatimore shitje për Dhimitraq Ziu, datë 21.12.2020, vlerë 49.980 lekë.
- Faturë tatimore shitje për Dhimitraq Ziu, datë 21.10.2020, vlerë 63.000 lekë.
- Faturë e thjeshtë tatimore nr.**, datë 23.10.2020, blerës Dhimitraq Ziu, vlerë 50.000 lekë.
- Fotografi të objektit dhe të tokës (me të mbjellat përkatëse).
- Vërtetim nr. ***prot., datë 12.07.2022, nga Njësia Administrative Poshnje, Zyra e Bujqësisë, sipas së cilës vërtetohet se familja e Dhimitraq Ziu ka përfituar 11.310 m2 tokë bujqësore nga ligji 7501, me AMTP, nr. ****në fshatin Poshnje, Bashkia Dimal.
- **Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ**
- ASHK Berat, me shkresën nr. *****prot., datë 22.06.2023, nuk e konfirmon pasurinë e mësipërme të regjistruar në emër të subjektit.
- **Në proces verbalin e datës 03.07.2023**, lidhur me origjinën e pronës, subjekti paraqiti vërtetim nga Njësia Administrative Poshnje. Deklaroi se gjendja e objektit është e njëjtë dhe nuk ka patur ndryshime të mëtejshme. Në certifikatën e vitit 1991 motra dhe vëllai nuk kanë qenë në përbërjen familjare. Kontrata e pjesëtimit përmban të gjitha pasuritë e disponuara nga prindërit. Ata nuk disponojnë pasuri të tjera përveç atyre të cituara në këtë kontratë. Sqaroi se prindërit kanë shprehur vullnetin e tyre të lirë, lidhur me pasuritë e disponuara prej tyre. Ai dhe familja e tij janë kujdesur dhe vazhdojnë të kujdesen për ta. Prindërit banojnë në shtëpinë në Poshnjë. Paraqiti: Vërtetim i Njesisë Administrative Poshnje, nr. *** prot., datë 26.08.2020, për Dhimitraq Ziu, ish banor i fshatit Poshnje, i cili ka në pronësi pasurinë me nr. *** e llojit arë+ truall, përfituar nga ligji nr. 7501, datë 19.7. 1991, nga komisioni i fshatit dhe azhornuar në vitin 1994, në fshatin Poshnje dhe ndërtesa me sip. 100 m2 është

ndërtuar nga prindërit e tij në vitin 1970 dhe më pas është përfitur nga Dhimitraq Ziu.

- Certifikatë familjare dt. 25.3.1991, me K/familjar shtetasin Jorgaq Ziu.
- **Në proces verbalin e datës 13.10.2023**, subjekti sqaroi se një pjesë të mobiljeve të shtëpisë në Berat, e cila më pas është shitur, i kanë përdorur për shtëpinë në Poshnje. Githashtu, përveç shpenzimeve të mirëmbajtjes së deklaruar më lart, për këtë banesë kanë shpenzuar për mobilim në vitin 2020, rreth 200.000 lekë.
- **Me postën elektronike të datës 24.10.2023**, subjekti sqaroi se për tokat e përfituara me AMTP, si dhe kontrata pjesëtimi e dhurimi, nuk ka kryer investime të rëndësishme, por ndër vite ka kryer shpenzime minimaliste për mirëmbajtjen, mbjelljen dhe kultivimin e ullinjve, hardhive e bimëve të arave.

Bazuar në deklarin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur si dhe në korrespondencën e administruar, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

Pasuria Arë, me sip. 700 m² (nga i cili truall 200 m²) + banesë me sip. 100 m², në Poshnje, Berat është përfitur në v. 2012, në bashkëpronësi 100% të subjektit dhe b/shortes, sipas kontratës së pjesëstitimit me prindërit e tij. Pjesëtimi në favor të tij dhe bashkëshortes, deklarohet nga subjekti për shkak të certifikatës familjare të vitit 1991, në të cilën nuk ishin motra dhe vllai i tij, si dhe për shkak të vullnetit personal të prindërive. Sipas dokumentacionit të paraqitur (vërtetim nga Njësia Administrative Poshnje), pasuria truall + ndërtesë, është përfitur nga prindërit me ligjin 7501. Në vitin 2019 subjekti ka kryer shpenzime për riparim dhe mirëmbajtje të shtëpisë, në shumën 933.000 Lekë, për të cilat ka paraqitur faturat përkatëse dhe deklaroi se si burim financiar kanë shërbyer kursimet e familjes në vitet 2019 - 2020.

- ✓ ***Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar. Pasuria është përfitur me kontratë pjesëtimi nga prindërit e tij, për të cilën janë deklaruar shpenzime riparimi dhe mirëmbajtje, në shumën rreth 933.000 lekë. Shpenzime mobilimi rreth 200.000 lekë. ASHK nuk konfirmon pasurinë e deklaruar.***

Pasuria Nr. 4

Apartament banimi me sip. 99.22 m², ndodhur në Tiranë. Regjistruar me nr.***. Blerë në vitin 2005, me kontratë porosie 107.22 m². Vlera 49.320 euro. Pjese takuese 50/50%.

Burimi i krijimit:

- a) nga kursimet familjare deri në vitin 2004 vlera 1.000.000 lekë;
- b) të ardhurat nga shitja e apartamentit të banimit në Berat, vlera 1.000.000 lekë
- c) borxh nga një person fizik 4.900.000 lekë, shlyer me të ardhurat nga paga e Dhimitraq Ziu 2005-2015 shuma 9.231.890 lekë; të ardhurat nga paga e Drita Ziu, 2005 - 2015, shuma 5.367.977 lekë; të ardhurat nga qiraja sipas kontratave, 2005 - 2015, shuma 2.522.000 lekë.

- **Dokumentacioni bashkëlidhur:**

- Certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë apartament me sip. totale 99.22 m2, regjistruar në emër të Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu, me nr.****, ndodhur në Tiranë. Data e lëshimit të certifikatës 15.2.2019. B/lidhur kartela e pasurisë + harta treguese e regjistrimit.
- Kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 11.2.2019, palë shitëse shoqëria "Sinani" shpk. dhe palë blerëse Drita Ziu e Dhimitraq Ziu, të një apartamenti me sip. 99.22 m2, regjistruar me nr. ***, ndodhur në Tiranë. Çmimi i shitjes së apartamentit në vlerën 49.320 euro, vlerë e cila është likuiduar tërësisht nga ana e shitësit, sipas Kontratës me Vërtetim nr. ***rep., nr. ***kol., datë 02.07.2004.
- Kontratë nr. ***rep., nr. *** kol., datë 02.07.2004, nënshkruar ndërmjet palës sipërmarrëse shoqëria e ndërtimit "Sinani" shpk. dhe palë porositëse Dhimitraq Ziu, të një objekti banimi me sip. 107.22 m2, vlera 49.320 euro. Pagesa do të kryhet në vlerën e kështit të parë 3.000 euro deri në 2.7.2004, kështi i dytë prej 25.000 euro do të kryhet deri në 30.08.2004, kështi i tretë 16.420 euro deri në 25. 10.2004 dhe kështi i mbetur prej 4.900 euro në momentin e marrjes në dorëzim të objektit të përfunduar.
- Deklaratë noteriale nr. ***rep., nr. ***kol., datë 30.10.2004, e shoqërisë Sinani shpk Tiranë, e cila deklaron se në zbatim të kushteve të kontratës nr. ***rep., nr. *** kol., datë 02.07.2004, porositësi Dhimitraq Ziu, përveç kështit të parë prej 3.000 euro të likuiduar me nënshkrimin e kontratës, ka likuiduar dhe kështin e dytë me mandat arkëtimin nr. 180, datë 23.08.2004, për shumën 25.000 euro, si dhe kështin e tretë prej 16.420 euro, me mandat arkëtimin nr.***, datë 30.10.2004.
- Kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme nr. ***rep., nr.*** kol., datë 24.02.2005, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Dhimitraq Ziu, Drita Ziu dhe palës blerëse S. Bode të pasurisë së paluajtshme nr. ***** lloji "njësi", me sip. totale 65.5 m2, i ndodhur në Berat. Çmimi i shitjes 1.000.000 lekë është likuiduar totalisht ndërmjet palëve, jashtë zyrës noteriale. B/lidhur dokumentacioni ligjor i pasurisë nr.****, regjistruar në emër të Dhimitraq Ziu, Drita Ziu datë 08.02.2005.
- Deklaratë noteriale nr. ***rep. nr. ***kol. datë 27.11.2019, nënshkruar ndërmjet palës huadhënëse S.Bode dhe palës huamarrëse Dhimitraq Ziu. Palët deklarojnë se kanë nënshkruar një deklaratë për dhënie e një huaje pa interes, në shumën 4.900.000 lekë. Shuma i është dhënë Dhimitraq Ziu në llogarinë e tij bankare në Bankën Emporiki, më datë 20.08.2004, me qëllim likuidimin e vlerës për pagesën e një apartamenti të ndodhur në Tiranë. Këtë shumë kanë rënë dakord që pala huamarrëse ta shlyej me këste vjetore pa interes. Për sa më sipër, palët deklarojnë se huaja është shlyer totalisht nga huamarrësi duke i paguar huadhenësit këstet vjetore me deklaratat e nënshkruara prej tyre.
Bashkëlidhur:
- Deklaratë (me shkrim dore) në të cilën shetasi Dhimitraq Ziu deklaron se në datë 20.08.2004 i ka marrë hua shetasit S. Bode shumën prej 4.900.000 lekë. Me huadhenësin kanë rënë dakord që shuma do të shlyhet pa interes, me këste vjetore. Deklarata është nënshkruar nga Dhimitraq Ziu dhe S. Bode.

- Deklaratë (me shkrim dore), në të cilën shtetasi Dhimitraq Ziu deklaroi se në datë 22.04.2006, i ka dhënë shtetasit Stiliano Bode kështu prej 500.000 lekë. Deklarata është nënshkruar nga Dhimitraq Ziu dhe Stiliano Bode.
 - Deklaratë (me shkrim dore) në të cilën shtetasi Dhimitraq Ziu deklaroi se në datë 28.07.2007 i ka dhënë shtetasit S. Bode kështu prej 500.000 lekë. Deklarata është nënshkruar nga Dhimitraq Ziu dhe S. Bode.
 - Deklaratë (me shkrim dore), në të cilën shtetasi Dhimitraq Ziu deklaroi se në datë 20.12.2008 i ka dhënë shtetasit S. Bode, kështu prej 500.000- lekë. Deklarata është nënshkruar nga Dhimitraq Ziu dhe S. Bode.
 - Deklaratë (me shkrim dore) në të cilën shtetasi Dhimitraq Ziu, deklaroi se në datë 14.08.2009 i ka dhënë shtetasit S. Bode, kështu prej 500.000 lekë. Deklarata është nënshkruar nga Dhimitraq Ziu dhe S. Bode.
 - Deklaratë (me shkrim dore), në të cilën shtetasi Dhimitraq Ziu deklaroi se në datë 20.11.2010, i ka dhënë shtetasit S. Bode, kështu prej 500.000 lekë. Deklarata është nënshkruar nga Dhimitraq Ziu dhe S. Bode.
 - Deklaratë (me shkrim dore) në të cilën shtetasi Dhimitraq Ziu deklaroi se në datë 22.10.2011 i ka dhënë shtetasit S. Bode, kështu prej 500.000 lekë. Deklarata është nënshkruar nga Dhimitraq Ziu dhe S. Bode.
 - Deklaratë (me shkrim dore), në të cilën shtetasi Dhimitraq Ziu deklaroi se në datë 10.11.2012 i ka dhënë shtetasit S. Bode, kështu prej 500.000 lekë. Deklarata është nënshkruar nga Dhimitraq Ziu dhe S. Bode.
 - Deklaratë (me shkrim dore), në të cilën shtetasi Dhimitraq Ziu deklaroi se në datë 16.11.2013 i ka dhënë shtetasit S. Bode, kështu prej 500.000 lekë. Deklarata është nënshkruar nga Dhimitraq Ziu dhe S. Bode.
 - Deklaratë (me shkrim dore), në të cilën shtetasi Dhimitraq Ziu deklaroi, se në datë 8.11.2014 i ka dhënë shtetasit S. Bode, kështu prej 450.000 lekë. Deklarata është nënshkruar nga Dhimitraq Ziu dhe S. Bode.
 - Deklaratë (me shkrim dore) në të cilën shtetasi Dhimitraq Ziu deklaroi, se në datë 31.11.2015 i ka dhënë shtetasit S. Bode, kështu prej 450.000 lekë. Me dhënien e kështit të mësipërm, ka shlyer të gjithë huanë prej 4.900.000 lekë dhënë nga Stiliano Bode. Deklarata është nënshkruar nga Dhimitraq Ziu dhe S. Bode.
- Mandat arkëtimi nr. ***, datë 15.10.2005, shoqëria "Sinani" shpk, arkëton nga Dhimitraq Ziu shumën 4.900 euro, likuidim përfundimtar.
- Nxjerrje llogarie në Emporiki Bank, në emër të Dhimitraq Ziu, periudha 1.1.2004 - 1.1.2005, në të cilën evidentohet transferimi i shumës 4.492.262 lekë, nga S. Bode tek Dhimitraq Ziu.
- Nxjerrje llogarie në Emporiki Bank, në emër të S. Bode – J. Bode (i ati i S. Bode), periudha 01.01.2003 - 01.01.2004, në të cilën evidentohet kreditimi i depozitës dyvjeçore, si dhe transferimi i shumës 4.492.262 lekë, nga llogaria dy vjeçore S. Bode tek Dhimitraq Ziu.

➤ **Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ**

- Banka Amerikane e Investimeve, me shkresën nr.***prot., datë 08.05.2023 konfirmon se shtetasi Dhimitraq Ziu ka qenë klient i bankës, nëpërmjet një llogarie kursimi, hapur në dt. 20.08.2004 dhe mbyllur me 03.10.2017.
- Evidentohet në dt. 20.08.2004, transferimi i shumave 4.492.262 lekë dhe 407.738 lekë nga llogaria e S. Bode tek llogaria e Dhimitraq Ziu.
- Në dt. 23.08.2004, Dhimitraq Ziu transferon shumën 1.755.000 lekë në depozitë 1 mujore, ndërsa shumën 3. 130.000 lekë e tërheq cash.
- Depozita maturohet deri në datën 28.10.2004, kur vlera 1.766.900 lekë tërhiqet cash nga Dhimitraq Ziu.
- ASHK Tiranë Jug, me shkresën nr. 21/26 prot., datë 26.6.2023, konfirmon pasurinë nr.****, ZK.***, në emër të Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu. B/lidhur përgjigjes ndodhet:
 - Kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme nr. *** rep. nr. 155 kol., datë 11.2.2019, palë shitëse shoqëria "Sinani" shpk. dhe palë blerëse Drita Ziu e Dhimitraq Ziu, të një apartamenti me sip. 99.22 m2, regjistruar me nr. *****, ndodhur në Tiranë. Çmimi i shitjes së apartamentit në vlerën 49.320 euro, vlerë e cila është likuiduar tërësisht nga ana e shitësit, sipas Kontratës me Vërtetim nr. ***rep., nr. *** kol., datë 02.07.2004.
- ASHK online, konfirmon pasurinë *****, në emër të Dhimitraq Ziu, Drita Koli Ziu, status "aktive".
- Në ILDKPKI administrohet:
 - Mandat arkëtim nr.**, datë 02.07.2004, nga Dhimitraq Ziu, vlera 3.000 euro, kësti i parë shtëpia.
 - Mandat arkëtim nr.***, datë 23.08.2004, nga Dhimitraq Ziu, vlera 25.000 euro, kësti i dytë i shtëpisë, përfitues "Sinani" shpk.
 - Mandat arkëtim nr. 227, datë 30. 10.2004, nga Dhimitraq Ziu, vlera 16.420 euro, kësti i tretë.
- Subjekti ka deklaruar se burimi i të ardhurave të huadhenësit, kanë qenë të ardhurat nga emigracioni të cilat i ka patur gjendje në depozitë.
- **Në proces verbalin e datës 3.7.2023**, subjekti sqaroi se burimi financiar i fondeve të dhëna hua nga S. Bode janë të ardhurat e tij dhe familjes së tij. Në periudhën që është dhënë huaja, kryesisht të ardhurat kanë patur si burim emigracionin dhe të ardhura të babait të tij, fakt i cili vërtetohet nga depozita bankare, e cila ishte në emër të të dyve. J. Bode është babai i S. Bode. Transferimi i fondeve në llogarinë e tij bankare ka ndodhur në marrëveshje midis palëve, veprim i cili nuk do mund të ndodhte, nëse njëra nga palët pjesëmarrëse në llogarinë bankare nuk do e aprovonte. Sqaroi se depozita ishte çelur kohë më parë se të kryhej

marrëveshja e huasë pavarësisht se banka nuk disponon gjithë historikun e llogarisë dyemërore.

- **Në proces verbalin e datës 13.10.2023**, subjekti sqaroi se mobilimi i shtëpise në Tiranë është kryer në vitet 2004 - 2005 dhe ka shpenzuar vlerën rreth 500.000 lekë.

Bazuar në deklarinimin e subjektit, sqarimet dhe dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar, në mënyrë të përmblodhur rezulton se:

- Apartamenti me sip. 99.22 m² në Tiranë, në zotërim 100% të subjektit deklarues dhe bashkëshortes së tij, është përfituar me kontratë sipermarrje në vitin 2004 dhe kontratë shitblerje në vitin 2019, në vlerën 49.320 euro. Pagesat janë kryer gjatë periudhës 2004-2005. Si burim financiar për likuidimin e kësteve të apartamentit, janë deklaruar; të ardhura nga kursimet familjare në vlerën 1.000.000 lekë, krijuar gjatë periudhës deri në vitin 2004; të ardhura nga shitja e apartamentit në Berat, me vlerën 1.000.000 lekë, e cila është likuiduar cash dhe pa mandat pagese (është paraqitur kontrata e shitjes së apartamentit në vitin 2004, në favor të shtetasit S. Bode); hua nga të afërm (S. Bode) në dt. 20.08.2004, në vlerën 4.900.000 lekë, për të cilën është paraqitur deklaratë noteriale për dhënien dhe marrjen mbrapsht të vlerës (huaja deklarohet totalisht e shlyer në v. 2015), si dhe është paraqitur dokumentacion për mundësinë financiare të këtij shtetasi për dhënien e huasë (depozitë bankare).
 - Huaja deklarohet e përfituar me transfertë bankare në Emporiki Bank, ku evidentohen kreditimet në dt. 20.08.2004, transferimi i shumave 4.492.262 lekë dhe 407.738 lekë nga llogaria e S. Bode tek llogaria e Dhimitraq Ziu, pa patur një përshkrim lidhur me qëllimin e transferimit të fondeve. Gjithashtu subjekti, terheq cash nga llogaria në Emporiki Bank në dt. 23.8.2004, vlerën 3.130.000 lekë dhe në dt. 28.10.2004, vlerën 1.766.900 lekë.
 - Konstatohet se me shetasin S. Bode, përveç huasë së sipërcituar, ka patur edhe transaksionin e shitjes së njësisë në Berat, në shumën 1.000.000 lekë v. 2004.
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe pergjigjen e ASHK.**
- ✓ **Dokumentacioni lidhur me të ardhurat nga pagat, që kanë shërbuer si burim pjesor për blerjen e apartamentit në Tiranë, v. 2004 - 2005, trajtohet në vijim, në rubrikat përkatëse të të ardhurave të subjektit dhe b/shortes.**
- ✓ **Huaja në shumën 4.900.000 lekë, nga shetasi S. Bode, i ka kaluar subjektit me transfertë bankare në v. 2004 dhe është shlyer nga ai përgjatë periudhës 2006 - 2015, me këste, me burim të ardhurat familjare.**
- ✓ **Janë deklaruar shpenzime mobilimi për apartamentin në Tiranë, në shumën totale rreth 500.000 lekë, v.2004 - 2005.**

- ✓ ***Konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.***

Pasuria Nr.5

Tokë arë 6.500 m2, nr. pasurie *** Poshnje, Berat. Burimi i krijimit: përfituar nga familja me ligjin 7501 dhe përpjestimi vullnetar i pasurisë. Vlerë 0 lekë. Pjesë takuese 50/50%.

➤ Dokumentacioni bashkëlidhur:

- Certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë arë, me sip totale 6.500 m2, regjistruar në emër të Jorgaq Ziu, me nr.***, ndodhur në Berat. Data e lëshimit të certifikatës 19.1.2012. B/lidhur kartela e pasurisë + harta treguese e regjistrimit.
- Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 26.08.2020, lëshuar nga ASHK Berat drejtuar shtetasit Dhimitraq Ziu, për kopje reference që administron ky institucion. B/lidhur ndodhet:
- Kontratë pjesëtimi vullnetar nr. ** rep., nr. *** kol., datë 10.02.2012, nënshkruar mes palëve Jorgaq Ziu, Evgjëni Ziu, Dhimitraq Ziu, Drita Ziu, për pasuritë që kanë në bashkëpronësi të ndodhura në Poshnje të Beratit, ZK ***. Konkretisht, sipas kontratës, Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu marrin në pronësi pasurinë nr.***, e llojit tokë arë, me sip. totale 6.500 m2.
- Certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë arë me sip totale 6.500 m2, regjistruar në emër të Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu me nr.***, ndodhur në Poshnje, Berat. Data e lëshimit të certifikatës 20.02.2012. B/lidhur harta treguese e regjistrimit.
- Vërtetim nr. *** prot. datë 12.07.2022 nga Njësia administrative Poshnje, Zyra e Bujqësisë, sipas së cilës vërtetohet se familja e Dhimitraq Ziu ka përfituar 11.310 m2 tokë bujqësore nga ligji 7501, me AMTP, nr.***, në fshatin Poshnje, Bashkia Dimal.
- ASHK Berat, me shkresën nr. *** prot., datë 22.06.2023, nuk e konfirmon pasurinë e mësipërme të regjistruar në emër të subjektit.

Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar. Pasuri e përfituar me AMTP dhe kontratë pjesëtimi/dhurimi.

Pasuria Nr. 6

Ullishte 1.450 m2, nr. pasurie *** Poshnje, Berat. Burimi i krijimit: përfituar nga familja me ligjin 7501 dhe përpjesëtimi vullnetar i pasurisë. Vlerë 0 lekë. Pjesë takuese 50/50%.

➤ **Dokumentacioni bashkëlidhur:**

- Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 26.08.2020, lëshuar nga ASHK Berat drejtuar shtetasit Dhimitraq Ziu, për kopje reference që administron ky institucion. B/lidhur ndodhet:
- Kontratë pjesëtimi vullnetar nr. ** rep. nr. *** kol. datë 10.02.2012, nënshkruar mes palëve Jorgaq Ziu, Evgjëni Ziu, Dhimitraq Ziu, Drita Ziu për pasuritë që kanë në bashkëpronësi, të ndodhura në Poshnje të Beratit, ZK****. Konkretisht, sipas kontratës, Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu marrin në pronësi pasurinë nr****, e llojit tokë ullishte, me sip. totale 1.450 m².
- Certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë Ullishte me sip. totale 1.450 m², regjistruar në emër të Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu, me nr.****, ndodhur në Poshnje, Berat. Data e lëshimit të certifikatës 20.02.2012. B/lidhur harta treguese e regjistrimit.
- Certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë Ullishte, me sip. totale 1.450 m², regjistruar në emër të Jorgaq Ziu, me nr.****, ndodhur në Poshnje, Berat. Data e lëshimit të certifikatës 19.01.2012. B/lidhur kartela e pasurisë + harta treguese e regjistrimit.
- Në ILDKPKI administrohet: Vërtetim nr.***prot., datë 12.07.2022, nga Njësia administrative Poshnje, Zyra e Bujqësisë, sipas së cilës vërtetohet se familja e Dhimitraq Ziu ka përfituruar 11.310 m² tokë bujqësore nga ligji 7501, me AMTP nr.***, në fshatin Poshnje, Bashkia Dimal.
- ASHK Berat, me shkresën nr. **** prot., datë 22.06.2023, nuk e konfirmon pasurinë e mësipërme të regjistruar në emër të subjektit.

Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar. Pasuri e përfituruar me AMTP dhe kontratë pjesëtimi.

Pasuria Nr. 7

Tokë arë 1.500 m², nr. pasurie 9/33, Poshnje, Berat. Përfituruar si dhuratë nga prindërit. Vlerë 0 lekë. Pjesë takuese 100%.

➤ **Dokumentacioni bashkëlidhur:**

- Shkresë kthim përgjigje nr. **** prot., datë 26.08.2020, lëshuar nga ASHK Berat drejtuar shtetasit Dhimitraq Ziu, për kopje reference që administron ky institucion. B/lidhur ndodhet:
- Kontratë pjesëtimi vullnetar nr. ** rep., nr. *** kol., datë 10.02.2012, nënshkruar mes palëve Jorgaq Ziu, Evgjëni Ziu, Dhimitraq Ziu, Drita Ziu, për pasuritë që kanë në bashkëpronësi, të ndodhura në Poshnje të Beratit, ZK ***. Konkretisht, sipas kontratës, Jorgaq Ziu, Evgjëni Ziu dhe Dhimitraq Ziu, marrin në pronësi pasurinë nr.***, e llojit tokë arë, me sip. totale 1.500 m².

- Certifikatë për vërtetim pronësie, të pasurisë arë, me sip. totale 1.500 m2, regjistruar në emër të Jorgaq Ziu, Evgjeni Ziu, Dhimitraq Ziu, me nr.***, ndodhur në Poshnje, Berat. Data e lëshimit të certifikatës 20.02.2012. B/lidhur kartela e pasurisë + harta treguese e regjistrimit.
- Kontratë dhurimi e pasurisë së paluajtshme nr. ***rep., nr. *** kol., datë 23.02.2012, palë dhuruese Jorgaq Ziu, Evgjeni Ziu dhe palë pranuese e dhurimit Dhimitraq Ziu, të pasurisë *** e llojit tokë arë, me sip. 1500 m. Dhuruesit deklarojnë se, tërësisht, pjesët e tyre takuese të pandara të pasurisë së paluajtshme me sip. totale 1.500 m2, ja dhurojnë pa kusht dhe kundërshtëpërblim pranuesit të dhurimit Dhimitraq Ziu, duke shprehur dëshirën e tyre që pranuesi i dhurimit të bëhet i vetmi pronar i pasurisë së paluajtshme.
- Certifikatë për vërtetim pronësie, të pasurisë arë, me sip. totale 1.500 m2, regjistruar në emër të Jorgaq Ziu, me nr. ***, ndodhur në Poshnje, Berat. Data e lëshimit të certifikatës 19.01.2012. B/lidhur kartela e pasurisë + harta treguese e regjistrimit.
- Vërtetim nr. *** prot., date 12.07.2022, nga Njësia Administrative Poshnje, Zyra e Bujqësisë, sipas së cilës vërtetohet se familja e Dhimitraq Ziu ka përfituar 11.310 m2 tokë bujqësore nga ligji 7501, me AMTP nr. ***, në fshatin Poshnje, Bashkia Dimal.
- ASHK Berat, me shkresën nr. *** prot., datë 22.06.2023, nuk e konfirmon pasurinë e mësipërme të regjistruar në emër të subjektit.

Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar. Pasuri e përfituar me AMTP dhe kontratë pjesëtimi/dhurimi.

Pasuria Nr. 8

Ullishte 1.450 m2, nr. pasurie 887/170 Poshnje, Berat. Burimi i krijimit: përfituar nga familja me ligjin 7501 dhe përpjesëtimi vullnetar i pasurisë. Vlere 0 lekë. Pjesë takuese 50/50%.

➤ **Dokumentacioni bashkëlidhur:**

- Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 26.08.2020, lëshuar nga ASHK Berat drejtuar shtetasit Dhimitraq Ziu, për kopje reference që administron ky institucion. B/lidhur ndodhet:
- Kontratë pjesëtimi vullnetar nr. **rep. nr. ***kol. datë 10.02.2012, nënshkruar mes palëve Jorgaq Ziu, Evgjeni Ziu, Dhimitraq Ziu, Drita Ziu për pasuritë që kanë në bashkëpronësi, te ndodhura ne Poshnje te Beratit, ZK***. Konkretisht, sipas kontrates, Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu marrin ne pronësi pasurine nr.*****, e llojit tokë ullishte, me sip. totale 1.450 m2.
- Certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë Ullishte me sip. totale 1.450 m2, regjistruar në emër të Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu, me nr.*****, ndodhur në

Poshnje, Berat. Data e lëshimit të certifikatës 20.02.2012. B/lidhur harta treguese e regjistrimit.

- Certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë Ullishte, me sip. totale 1.450 m², regjistruar në emër të Jorgaq Ziu, me nr.****, ndodhur në Poshnje, Berat. Data e lëshimit të certifikatës 19.01.2012. B/lidhur kartela e pasurisë + harta treguese e regjistrimit.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 12.7.2022, nga Njësia Administrative Poshnje, Zyra e Bujqësisë, sipas së cilës vërtetohet se familja e Dhimitraq Ziu ka përfituar 11.310 m² tokë bujqësore nga ligji 7501, me AMTP nr.***, në fshatin Poshnje, Bashkia Dimal.
- ASHK Berat, me shkresën nr. *** prot., datë 22.06.2023, nuk e konfirmon pasurinë e mësipërme të regjistruar në emër të subjektit.

Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar. Pasuri e përfituar me AMTP dhe kontratë pjesëtimi.

Pasuria Nr. 9

Tokë arë 1.000 m², nr. pasurie 335/5 Poshnje, Berat. Burimi i krijimit: përfituar nga familja me ligjin 7501 dhe përpjestimi vullnetar i pasurisë. Vlerë 0 lekë. Pjesë takuese 50/50%.

➤ **Dokumentacioni bashkëlidhur:**

- Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 26.08.2020, lëshuar nga ASHK Berat drejtuar shtetasit Dhimitraq Ziu, për kopje reference që administron ky institucion. B/lidhur ndodhet:
- Kontratë pjesëtimi vullnetar nr. ** rep., nr. *** kol., datë 10.02.2012, nënshkruar mes palëve Jorgaq Ziu, Evgjëni Ziu, Dhimitraq Ziu, Drita Ziu për pasuritë që kanë në bashkëpronësi të ndodhura në Poshnje të Beratit, ZK***. Konkretisht, sipas kontratës, Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu marrin në pronësi pasurinë nr. *** e llojit tokë arë, me sip. totale 1.000 m².
- Certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë arë me sip. totale 1.000 m², regjistruar në emër të Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu me nr.***, ndodhur në Poshnje, Berat. Data e lëshimit të certifikatës 20.02.2012. B/lidhur harta treguese e regjistrimit.
- Certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë arë me sip. totale 1.000 m², regjistruar në emër të Jorgaq Ziu. me nr.***, ndodhur në Poshnje, Berat. Data e lëshimit të certifikatës 19.01.2012. B/lidhur kartela e pasurisë + harta treguese e regjistrimit.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 12.07.2022, nga Njësia administrative Poshnje, Zyra e Bujqësisë, sipas së cilës vërtetohet se familja e Dhimitraq Ziu ka përfituar 11.310 m² tokë bujqësore nga ligji 7501, me AMTP nr.***, në fshatin Poshnje, Bashkia Dimal.

- ASHK Berat, me shkresën nr. *** prot., datë 22.06.2023, nuk e konfirmon pasurinë e mësipërme të regjistruar në emër të subjektit.

Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar. Pasuri e përfituar me AMTP dhe kontratë pjesëtimi.

Pasuria Nr. 10

- Tokë arë 160 m2, nr. Pasurie 337/5 Poshnjë, Berat. Burimi i krijimit: Përfituar nga familja me ligjin 7501 dhe pjesëtimi vullnetar i pasurisë. Vlera 0 Lekë. Pjesë takuese 50/50%.
- **Dokumentacioni bashkëlidhur:**
- Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 26.08.2020, lëshuar nga ASHK Berat drejtuar shtetasit Dhimitraq Ziu, për kopje reference që administron ky institucion. B/lidhur ndodhet:
- Kontratë pjesëtimi vullnetar nr. ** rep., nr. *** kol., datë 10.02.2012, nënshkruar mes palëve Jorgaq Ziu, Evgjëni Ziu, Dhimitraq Ziu, Drita Ziu për pasuritë që kanë në bashkëpronësi të ndodhura në Poshnje të Beratit, ZK***. Konkretisht, sipas kontratës, Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu marrin në pronësi pasurinë nr. *** e llojit tokë arë, me sip. totale 160 m2.
- Certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë arë me sip. totale 160 m2, regjistruar në emër të Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu me nr.***, ndodhur në Poshnje, Berat. Data e lëshimit të certifikatës 20.02.2012. B/lidhur harta treguese e regjistrimit.
- Certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë arë me sip. totale 160 m2, regjistruar në emër të Jorgaq Ziu. me nr.***, ndodhur në Poshnje, Berat. Data e lëshimit të certifikatës 19.01.2012. B/lidhur kartela e pasurisë + harta treguese e regjistrimit.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 12.07.2022, nga Njësia Administrative Poshnje, Zyra e Bujqësisë, sipas së cilës vërtetohet se familja e Dhimitraq Ziu ka përfituar 11.310 m2 tokë bujqësore nga ligji 7501, me AMTP nr.*** , në fshatin Poshnje, Bashkia Dimal.
- ASHK Berat, me shkresën nr. *** prot., datë 22.06.2023, nuk e konfirmon pasurinë e mësipërme të regjistruar në emër të subjektit.

Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar. Pasuri e përfituar me AMTP dhe kontratë pjesëtimi.

Pasuri e luajtshme Nr. 1

Automjet me targë A*****M, Mercedes Benz, vit prodhimi 2013. Blerë me kontratë noteriale dt. 18.01.2022. Vlera 1.690.000 lekë. Pjesë takuese 50/50%. Burimet e krijimit: Vlera 842.000 lekë nga shitja e automjetit të mëparshëm; 848.000 lekë nga kursimet familjare dhe gjendja në banesë.

➤ **Dokumentacioni bashkëlidhur:**

- Kontratë shitblerje për automjete datë 18.01.2022, palë shitëse “Auto – Almet” shpk, palë blerëse Dhimitraq Ziu, Gjergji Ziu, të një automjeti Mercedes Benz Glk, vit prodhimi 2013, nr. Shasie *****, kundrejt vlerës 1.690.000 Lekë.

B/lidhur:

- Fatura tatimore dt. 18.01.2022, vlerë 1.690.000 lekë;
- Deklaratë dt. 19.01.2022 nënshkruar nga palët “Auto-Almet” shpk, Dhimitraq Ziu, Gjergji Ziu, në të cilën deklarohet se subjekti “Auto-Almet” i ka shitur palës blerëse Dhimitraq Ziu dhe Gjergji Ziu, automjetin Mercedes Benz, sipas faturës nr. ** dt. 18.01.2022, vlerë 1.690.000 lekë. Gjithashtu pala blerëse i ka shitur “Auto-Almet” shpk, automjetin që dispononin në pronësi të tyre, lloj Mercedes Benz E200 nr. Shasie*****, sipas faturës së blerjes nr.**, dt 18.01.2022, vlerë 842.000 lekë. Diferenca 848.000 lekë e ngelur nga shitblerja e automjeteve është likujduar nga pala blerëse në dt. 19.01.2022, në llogarinë e Auto –Almet shpk, në bankën BKT.
- Mandat depozitimi në BKT, datë 19.01.2022, Dhimitraq Ziu depoziton në llogarinë e Auto Almet shpk, për blerje automjeti, shumën 848.300 lekë. Të ardhurat nga kursimet.
- Deklaratë zhdoganimit dt. 30.12.2021, Auto Almet shpk , të automjetit Mercedes Benz GLK, viti 2013.
- Leje qarkullimi automjeti Mercedes Benz GLK, me targë A****M, në emër të Dhimitraq Ziu.
- Kontratë shitblerje për automjete datë 18.01.2022, palë shitëse Dhimitraq Ziu e Gjergji Ziu, palë blerëse “Auto Almet” shpk, të automjetit Mercedes Benz E200 nr. Shasie *****, kundrejt vlerës 842.000 lekë. B/lidhur fatura e blerjes së automjetit nr.**, dt. 18.01.2022.

➤ **Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ**

- **DPSHTRR**, me shkresën nr. *** prot., datë 12.05.2023, konfirmon në pronësi të Dhimitraq Ziu dhe Gjergji Ziu, me targë A****M. B/lidhur:
- Kontratë shitblerje për automjete datë 18.01.2022, palë shitëse “Auto Almet” shpk, palë blerëse Dhimitraq Ziu dhe Gjergji Ziu, të një automjeti Mercedes Benz GLK Nr shasie *****kundrejt vlerës 1.690.000 lekë. Fatura tatimore nr. ** dt. 18.01.2022, vlerë 1.690.000 lekë.
 - Kontratë shitblerje për automjete datë 18.01.2022, palë shitëse Dhimitraq Ziu e Gjergji Ziu, palë blerëse “Auto Almet” shpk, të automjetit Mercedes Benz E200 nr. Shasie*****, kundrejt vlerës 842.000 lekë. B/lidhur fatura e blerjes së automjetit nr. 35, dt 18.01.2022.
- **Në procs verbalin e dt 13.10.2023**, subjekti sqaroi se lidhur me shitjen dhe blerjen e automjeteve prej tij, janë paguar taksat të cilat janë dorëzuar pranë institucioneve përkatëse. Shitja e këtyre automjeteve me vlerë më të lartë se ajo e blerjes ka ndodhur si rezultat i ndryshimit të tregut dhe mirëmbajtjes së tyre prej tij. Për pagesën e tatimit në burim për fitimin e realizuar, paraqiti shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 16220/1 prot., datë 12.10.2023, në të cilën konfirmohet se për të ardhurat e realizuara nga veprimet e shitblerjes së automjeteve personale, nuk aplikohet tatim mbi të ardhurat.

Konstatohet se automjeti Mercedes Benz i blerë në dt. 26.10.2016 në vlerën 600.000 leke, i është shitur ne dt. 18. 1.2022, shoqërisë "Auto Almet" shpk, në vlerën 842.000 lekë dhe të ardhurat nga shitja e këtij mjeti janë përdorur pjesërisht për blerjen e automjetit aktual Mercedes Benz, me vlerë 1.690.000 lekë.

Qëndrimi i Trupës Vlerësuese, parashtrohet në vijim.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përqigjen e DPSHTRR.**

Pasuri e luajtshme Nr. 2

Automjet me targë A*****C, Mercedes Benz, vit prodhimi 2008. Blerë me kontratë noteriale dt. 26.10.2016. Vlera 600.000 lekë. Pjesë takuese 50/50%. Burimet e krijimit: vlera 500.000 lekë nga shitja e automjetit të mëparshëm; 100.000 lekë nga kursimet familjare 2016. B/lidhur fatura e blerjes së automjetit nr. **, dt. 18.01.2022.

➤ **Dokumentacioni bashkëlidhur:**

- Kontratë shitje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.10.2016, palë shitëse A. K dhe palë blerëse Dhimitraq Ziu e Gjergji Ziu, të automjetit Mercedes Benz EI, vit prodhimi 2008, nr. shasie *****, kundrejt vlerës 600.000 lekë, shumë e cila është likuiduar nga blerësat, jashtë zyrës noteriale.
- Faturë zhdoganimit automjeti, datë 6.10.2016, nga A. Kaziu.
- Certifikata e pronësisë së mjetit rrugor, datë 1.11.2016, Mercedes Benz me targë A*****C, në emër të Gjergji Ziu dhe Dhimitraq Ziu.
- Kontratë shitje mjeti nr. ***rep., nr. ***kol., datë 03.11.2016, palës shitëse Dhimitraq Ziu dhe palë blerëse E. Gjoka, të automjetit Mercedes Benz, me targë T****P, nr. shasie *****, kundrejt vlerës 500.000 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

- DPSHTRR, me shkresën nr. *** prot., datë 12.05.2023, konfirmon se shtetasit Dhimitraq Ziu dhe Gjergji Ziu kanë patur në pronësi automjetin me targë A***Y sipas kontratës b/lidhur: Kontratë shitje automjeti nr. *** rep. nr. *** kol. datë 26.10.2016, palë shitëse A. K dhe palë blerëse Dhimitraq Ziu e Gjergji Ziu, të automjetit Mercedes Benz E****I, vit prodhimi 2008, nr. Shasie*****, kundrejt vlerës 600.000 lekë, shumë e cila është likuiduar nga blerësat, jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitje mjeti nr. ***rep., nr.***kol., datë 03.11.2016, palë shitëse Dhimitraq Ziu dhe palë blerëse E. Gj, të automjetit Mercedes Benz, me targë T****P, nr. shasie *****, kundrejt vlerës 500.000 lekë.

- Në proces verbalin e datës 13.10.2023, subjekti sqaroi se burimi për blerjen e automjetit me targë A****C janë të ardhurat nga shitja e automjetit me targa T****P, në shumën 500.000 lekë, të cilat sipas kontratës së shitjes dt. 03.11.2016, janë paguar jashtë zyrës noteriale ne dt. 26. 10.2016 dhe më pas është finalizuar akti para noterit një javë më vonë, për arsye të mungesës së kohës fizike.
- ✓ ***Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me burimin financiar për blerjen e automjetit me targë A****C, i cili është shitur ne v. 2022. Konfirmohen nga DPSHTRR kontratat e shitblerjes.***

Pasuri e luajtshme nr. 4

- Automjet me targë T****P, Mercedes Benz, vit prodhimi 1985. Blerë me kontratë noteriale dt.03.05.2008. Vlera 600.000 lekë. Pjesë takuese 50/50%. Burimet e krijimit: vlera 600.000 lekë nga shitja e automjetit të mëparshëm.
- Automjet me targë T****K, Mercedes Benz, vit prodhimi 1985. Blerë më 20.10.2002. Vlera 1.000 euro. Pjesë takuese 100%. Burimi i krijimit: kursimet familjare - 2002.

➤ Dokumentacioni bashkëlidhur:

- Kontratë shitje automjeti nr. *** rep., nr.*** kol., datë 03.05.2008, palë shitëse A. S (perfaqësuar nga A. K) dhe palë blerëse Dhimitraq Ziu, të automjetit Mercedes Benz, vit prodhimi 1996, nr. shasie ***** kundrejt vlerës 600.000 lekë, shumë e cila është likuiduar nga blerësat, jashtë zyrës noteriale.
- Faturë zhdoganimit automjeti, datë 04.04.2008 + leje qarkullimi.
- Kontratë shitje mjeti nr. ***rep., nr. *** kol., datë 03.03.2008, palës shitëse Dhimitraq Ziu dhe palë blerëse A. D, të automjetit Mercedes Benz, me targë T****K, nr. shasie *****, kundrejt vlerës 600.000 lekë.
- Kontratë shitje mjeti, përkthyer në gjuhën shqipe, sipas vërtetimit nr. ***, datë 22.10.2002, palë shitëse K. S dhe palë blerëse Dhimitraq Ziu, të automjetit Mercedes Benz, nr. Shasie*****, kundrejt vlerës 1.000 euro.
- Leje qarkullimi.

🚦 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

- DPSHTRR, me shkresën nr. ***prot., datë 12.05.2023, nuk e konfirmon automjetin me targë T****K, në pronësi të shtetasit Dhimitraq Ziu. Konfirmon se shtetasi Dhimitraq Ziu ka patur në pronësi automjetin me targë A****F (referuar dosjes targa e mëparshme T****P), sipas kontrates b/lidhur.

- Kontratë shitblerje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 03.05.2008, palë shitëse A. S (perfaqësuar nga A. K) dhe palë blerëse Dhimitraq Ziu, të automjetit Mercedes Benz, vit prodhimi 1996, nr. shasie ***** kundrejt vlerës 600.000 lekë, shumë e cila është likuiduar nga blerësat, jashtë zyrës noteriale.
- Në proces verbalin e datës 03.07.2023, subjekti sqaroi se automjeti me targë T****K nr. shasie ***** është blerë prej tij në vitin 2002, në shtetin gjerman, në vlerën 1.000 euro. Në vlerë nuk janë përfshirë taksat doganore dhe shpenzime të tjera të paguara për transportin dhe mirëmbajtjen e mjetit. Nuk ka paguar tatim fitimi për shkak të investimeve të kryera në të. Paraqiti:
 - Vërtetim zhdoganimi dt. 06. 11.2002, vërtetim hyrje dhe mandat pagese dt. 03.11.2002, pranë Bankës së Kursimeve, në vlerën 150.497 lekë.
 - Në proces verbalin e datës 13.10.2023, subjekti sqaroi se lidhur me shitjen dhe blerjen e automjeteve prej tij, janë paguar taksat të cilat janë dorëzuar pranë institucioneve përkatëse. Shitja e këtyre automjeteve me vlerë më të lartë se ajo e blerjes ka ndodhur si rezultat i ndryshimit të tregut dhe mirëmbajtjes së tyre prej tij. Për pagesën e tatimit në burim për fitimin e realizuar, paraqiti shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr.***prot., datë 12.10.2023, në të cilën konfirmohet se për të ardhurat e realizuara nga veprimet e shitblerjes së automjeteve personale, nuk aplikohet tatim mbi të ardhurat.

Konstatohet se, automjeti Mercedes Benz me targë T**K, nr. Shasie *****është blerë në vitin 2002, në vlerën 1.000 euro dhe shitur dt. 03.03.2008, në vlerën 600. 000 lekë. Të ardhurat nga shitja e automjetit, janë përdorur si burim financiar për blerjen e automjetit tjetër M. Benz në dt. 03.05.2008, vlerë 600.000 lekë.**

Qëndrimi i Trupës në lidhje me automjetin Mercedes Benz me targë T*K, nr. Shasie *****blerë në vitin 2002, në vlerën 1.000 euro dhe shitur dt. 03.03.2008, në vlerën 600. 000 lekë, i cili ka shërbyer si burim për blerjen e automjetit me targë T****P, Mercedes Benz, vit prodhimi 1985, blerë me kontratë noteriale dt.03.05.2008:***

Shitja e automjetit Mercedes Benz me targë T*K ka gjeneruar të ardhura për subjektin, për të cilat duhej të ishin paguar detyrimet përkatëse tatimore sipas legjislacionit në fuqi. Neni 7 i Ligjit Nr. 8438 datë 28.12.1998 “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT” i ndryshuar, nuk përjashton fitimin e gjeneruar nëpërmjet shitjes së automjeteve personale, për më tepër që diferenca e konsiderueshme ndërmjet blerjes dhe shitjes (më shumë se dyfishi), nuk legjitimohet nëpërmjet dokumentacionit (faturave) të kryerjes së shërbimeve përkatëse, që mund të kenë çuar në rritjen e vlerës.***

Interpretimi ligjor i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, është kontradiktor dhe jo i qartë për sa kohë kjo Drejtori ka pranuar dhe pranon pagimin e detyrimeve tatimore në rastet e mësipërme sipas praktikave të hasura në procesin e vlerësimit kalimtar, për pagimin e detyrimeve tatimore të të ardhurave të gjeneruara, konkretisht nëpërmjet shitjes së automjeteve personale. Sa më sipër, Trupa konstaton se detyrimet tatimore duhej të ishin

*paguar në rastin e mësipërm, për të konsideruar si të ligjshëm sipas deklaramit të subjektit, burimin e krijimit të pasurisë pasardhëse, automjetit me targë e targë T***P, Mercedes Benz, vit prodhimi 1985, blerë me kontratë noteriale dt. 03. 05. 2008.*

*Sa më sipër, subjektit i është bërë i ditur qëndrimi i Trupës pas dërgimit të Relacionit paraprak. Nëpërmjet shkresës me Nr. **** prot, datë 07.05.2024, subjekti parashtron si më poshtë vijon:*

“ Lexova me vëmendje raportin e hollësishëm të përgatitur nga Trupa e Vleresimit për Deklaratën e Pasurisë në të cilën janë paraqitur saktë pasuritë që unë e familja ime disponojmë , të ardhurat e shpenzimet realizuara nga unë e familja ime si dhe detyrimet finaciare të familjes.

Përsa i përket gjetjeve tuaja për ndryshimin e pronësisë së automjeteve ato janë të sakta dhe i pranoj.

*Më lejoni t’ju sqaroj në lidhje me shitjen e automjetit me targë T***K dhe automjetit me targë A****C për të cilët konstatimi Juaj për pagimin e tatimit mbi të ardhurat personale të realizuara nga shitja e tyre është i drejtë.*

*Në lidhje me këtë fakt u paraqita pranë organeve tatimore dhe nga sistemi i DPT kam printuar Urdhër Pagesën për këtë detyrim të cilin e kam derdhur në Raiffeisen Bank. Sqaroj se pagesa për automjetin me targë T***K është 46 996 lekë dhe për automjetin me targë A****C është 36 300 lekë.(bashkëlidhur gjeni Urdhër Pagesën si dhe Mandatin e Pagesës).”*

Bashkëlidhur Urdhër pagese 1800 tatimi mbi të ardhurat personale, datë 07.05.2024 dhe mandat arkëimi për derdhje detyrimi në Raiffeissen Bank.

✓ **Konfirmohen nga DPSHTRR kontratat e shitblerjes.**

Pasuri e luajtshme nr. 5

- Automjet me targë B****A, Peugeot 405, vit prodhimi 1992. Blerë në vitin 2000. Vlera 120.000 lekë. Pjesë takuese 50/50%. Burimet e krijimit: vlera 50.000 lekë nga shitja e automjetit të mëparshëm; 70.000 lekë , të ardhurat familjare 1998 - 2000.
- Automjet me targë B****A, Seat Ibiza, vit prodhimi 1985. Blerë në vitin 1994. Vlera 80.000 lekë. Pjesë takuese 50/50%. Burimet e krijimit: kursime nga të ardhurat familjare deri 1994.

Dokumentacioni bashkëlidhur:

- Kontratë shitje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.12.2000, palë shitëse A. Ç dhe palë blerëse Dhimitraq Ziu, të automjetit Peugeot, kundrejt vlerës 120.000 lekë, shlyer jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.10.2001, me palë dhuruese Dhimitraq Ziu dhe pranues i dhurimit D. J, të automjetit Peugeot, targë B*****.

- Vërtetim nr. **** prot., datë 20.04.2018, nga DPSHTRR Berat, për shtetasin Dhimitraq Ziu, i cili ka zotëruar automjetin me targë B****A, tipi Seat, deri në vitin 21.12.2000, kur ka kaluar në pronësit të shtetasit I. Z B/lidhur ndodhet kartela e automjetit, datë 18.05.1995.
- Kontratë shitje automjeti, datë 20. 11.2000, palë shitëse Dhimitraq Ziu dhe palë blerëse I. Z, të automjetit Seat, kundrejt shumës 200.000 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

- DPSHTRR, me shkresën nr. **** prot., datë 12.05.2023, nuk i konfirmon automjeret në pronësi të shtetasit Dhimitraq Ziu.
- Në proces verbalin dt. 03.07.2023, subjekti deklaroi se automjeti i shitur dhe përdorur si burim për blerjen e këtij automjeti, ka qenë shitja e automjetit Seat Ibiza, me targë B****A, në vitin 2000, në vlerën 200.000 lekë.
- Në proces verbalin e datës 13.10.2023, subjekti sqaroi se lidhur me shitjen dhe blerjen e automjeteve prej tij, janë paguar taksat, të cilat janë dorëzuar pranë institucioneve përkatëse. Shitja e këtyre automjeteve me vlerë më të lartë se ajo e blerjes ka ndodhur si rezultat i ndryshimit të tregut dhe mirëmbajtjes së tyre prej tij. Për pagesën e tatimit në burim për fitimin e realizuar, paraqiti shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nr. **** prot., datë 12.10.2023, në të cilën konfirmohet se për të ardhurat e realizuara nga veprimet e shitblerjes së automjeteve personale, nuk aplikohet tatim mbi të ardhurat.

Konstatohet se, automjeti Seat Ibiza, me targë B*A, është blerë në vitin 1995, në vlerën 80.000 lekë dhe është shitur në dt. 20. 11.2000, në vlerën 200.000 lekë. Të ardhurat nga shitja e automjetit, janë përdorur si burim financiar për blerjen e automjetit tjetër Peugeot, në 14. 12.2000, vlerë 120.000 lekë. Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me diferencën e vlerës së shitjes dhe blerjes së automjeteve, të shitura.***

Ashtu si në rastin e automjetit të mësipërm, mbi pagimin e detyrimeve përkatëse tatimore, Trupa mban të njëjtin qëndrim, por në rastin konkret gjen zbatim neni 32, pika 1.1, e ligjit nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat", i ndryshuar.

Likuiditetet:

- Gjendje cash 900.000 lekë. Kursime nga të ardhurat familjare viti 2016 - 2023. Pjesë takuese 50/50%.
- Në proces verbalin e datës 13.10.2023, subjekti sqaroi lidhur me deklarin e gjendjes cash dhe huadhënien kunatës, deklaruar ne v. 2016 dhe paraqiti:
 1. Deklaratë (me shkrim dore) e shtetas E. Plaku, e cila deklaron se në dt. 20.10.2016 i ka marrë motrës së saj shumën 400.000 lekë dhe do t'ja kthejë sapo t'i krijohet mundësia.
 2. Deklaratë (me shkrim dore) e shtetas Drita Ziu, e cila deklaron se në dt. 20.11.2019 motra E. Plaku i ka kthyer shumën 400.000 lekë të marrë hua në dt. 20.10.2016.

Të ardhurat janë të mjaftueshme për realizimin e gjendjes cash.

- Llogari bankare në ISP Bank, vlerë 1.000.000 lekë. Burimi i krijimit: kursime familjare në vitet 2005 - 2015. Pjesë takuese 100%.

B/Lidhur:

1. Levizjet e llogarisë në emër të Dhimitraq Ziu pranë ISP Bank, gjatë periudhës 1.1.2016 - 4.10.2022. Evidentohet depozitimi cash 996.000 lekë nga Dhimitraq Ziu në datë 25.2.2016, me përshkrimin "për Bono Thesari". Në datë 10.03.2016 është transferuar shuma 1.000.000 lekë. B/lidhur vërtetim nga ISP Bank, për të ardhurat e realizuara nga interesat bankare, gjatë vitit 2016, në shumën totale neto 16.371 lekë.
2. Intesa Sanpaolo Bank, me shkresën nr.***, dt. 15.05.2023 konfirmon llogarinë rrjedhëse në emër të Dhimitraq Ziu dhe gjendjen në llogari dt. 08.03.2023, në vlerën 1.010.616 lekë. B/lidhur levizjet e llogarisë në të cilën evidentohet se çelja e llogarisë dhe depozitimi fillestar dt. 25.02.2016 i shumës 996.000 lekë, me përshkrim "për Bono Thesari". Në dt. 10.03.2016 transferohet shuma 1.000.000 lekë, si investim në Bono Thesari. Në dt. 09.03.2017 investimi është maturuar dhe kredituar sërish në llogari rrjedhëse. Në vijim, nuk janë kryer transaksione bankare dhe gjendja e llogarisë nuk ka ndryshuar.

Konstatohet se. Llogaria është krijuar në vitin 2016 nëpërmjet depozitimit cash dt.25.2.2016, të shumës 1.000.000 lekë. Nuk janë kryer veprime të tjera pas çeljes së llogarisë.

Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ISP Bank.

- Llogari page në Tirana Bank, vlerë 1.420.804 lekë. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga në vitet 2011 - 2023. Pjesë takuese 100%. B/Lidhur:
1. Lëvizjet e llogarisë në emër të Dhimitraq Ziu, pranë Tirana Bank, gjatë periudhës 1.6.2021 - 2.3.2023. Gjendje në llogari në datë 2.3.2023, në vlerën 1.540.593 lekë.

 HETIMI ADMINISTRATIV

- Tirana Bank, me shkresën nr.***, dt. 08.05.2023, konfirmon llogari page në emër të Dhimitraq Ziu, me gjendje në dt. 08.03.2023, në vlerën 1.540.593 lekë. B/lidhur levizjet e llogarisë në të cilën evidentohet se llogaria është kredituar nga pagat, prej vitit 2011 të çeljes së llogarisë, ku gjendja fillestare e së cilës ishte akumuluar në vlerën 130.000 lekë, dt. 31. 12.2011 dhe është shtuar/pakësuar ndër vite.

Konstatohet se, llogaria është krijuar gjatë periudhës 2011 - 2023, nga akumulimi i pagave të kredituara.

Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Tirana Bank. Llogaria është deklaruar referuar gjendjes në datë 02.03.2023, ndërsa konfirmimi bankar pasqyron datën 08.03.2023.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

Subjekti deklaron:

- Të ardhura nga punësimi në Rajonin nr.2, të Policisë. Periudha 25.01.1986 - 05.06.1986. Shuma e të ardhurave 2.427 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Repartin nr. 326, Tiranë. Periudha 06.06.1986 - 15.10.1990. Shuma e të ardhurave 34.276 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në D.R. Publik Berat. Periudha 16.10.1990 - 31.12.1995. Shuma e të ardhurave 235.163 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në D.R. Publik Berat. Periudha 01.01.1996 - 31.01.2001. Shuma e të ardhurave 995.385 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Komisariatit e Policisë Lushnjë. Periudha 01.02.2001 - 28.02.2003. Shuma e të ardhurave 767.609 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Komisariatit e Policisë Mallakastër. Periudha 01.03.2003 - 31.08.2003. Shuma e të ardhurave 184.138 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Komisariatit e Policisë Durrës. Periudha 01.09.2003 - 30.05.2004. Shuma e të ardhurave 404.935 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë e Policisë Tiranë. Periudha 01.06.2004 - 15.07.2004. Shuma e të ardhurave 64.130 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Periudha 16.07.2004 - 09.02.2016. Shuma e të ardhurave 9.378.484 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë. Periudha 10.02.2016 - 01.06.2021. Shuma e të ardhurave 7.065.175 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë. Periudha 01.06.2021 - 08.07.2021. Shuma e të ardhurave 178.415 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Periudha 08.07.2021 - 01.11.2021. Shuma e të ardhurave 482.959 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës. Periudha 01.11.2021 - 01.10.2022. Shuma e të ardhurave 1.218.402 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër. Periudha 01.10.2022 - 01.03.2023. Shuma e të ardhurave 853.576 lekë.
- Të ardhura nga Komiteti Shqiptar i Birësimeve, shuma 18.000 lekë.
- Të ardhura nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi, shuma 39.500 lekë.
- Të ardhura nga pensioni i babait Jorgaq Ziu, periudha korrik 1991 - dhjetor 2012, shuma 2.359.029 lekë.
- Të ardhura nga pensioni i babait Jorgaq Ziu, periudha dhjetor 2012 - prill 2018, shuma 1.265.088 lekë.
- Të ardhura nga pensioni i nënës Evgjëni Ziu, periudha 1987 - prill 2014, shuma 962.325 lekë.
- Të ardhura nga pensioni i nënës Evgeni Ziu, periudha prill 2014 - prill 2018, shuma 474.114 lekë.

- Të ardhura nga shitja e apartamentit me sip. 65.5 m2, lagjja "30 Vjetori", Berat, nr.pasurie***. Shuma e të ardhurave 1.000.000 lekë.
- Të ardhura nga veprimtaria bujqësore dhe blektorale që nga viti 1991 e deri në vitin 2018, (1991 - 2000 vlera 900.000 lekë; 2000 - 2006 vlera 900.000 lekë; 2006 - 2018 vlera 2.500.000 leke). Shuma e të ardhurave 4.300.000 lekë.
- Të ardhura nga shitja e automjetit Mercedes Benz me targë A****C. Shuma e të ardhurave 842.000 lekë.
- Të ardhura nga shitja e automjetit Mercedes Benz me targë T****K. Shuma e të ardhurave 600.000 lekë.
- Të ardhura nga shitja e automjetit Seat Ibiza me targë B****A. Shuma e të ardhurave 200.000 lekë.
- Të ardhura nga shitja e pjesës takuese të pandarë të banesës me sip. 94 m2, , Berat. Shuma e të ardhurave 200.000 lekë.
- Të ardhura nga qiraja e ambientit me nr. pasurie **** nr. 1 Berat, periudha 2004 -1.3.2023. Shuma e të ardhurave 2.342.000 lekë.
- Të ardhura nga qiraja e ambientit me nr. Pasurie****, nr.2 Berat, periudha 1990 -Shuma e të ardhurave 2.926.500 lekë.
- Të ardhura nga qiraja e ambientit me nr. pasurie ***garazh në Berat, periudha 2008 -Shuma e të ardhurave 952.000 lekë.

Dokumentacioni bashkëlidhur:

- Vërtetim nr. *** prot., datë 12.08.2020, nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të shtetasit Dhimitraq Ziu, gjatë periudhës 25. 01.1986 - 05.06.1986, në shumën totale 2.427 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 26.08.2020 nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të shtetasit Dhimitraq Ziu, gjatë periudhës 10.06.1986 - 15.10. 1990, në shumën totale 34.276 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot. datë 26.08.2020 nga Drejtoria Vendore e Policisë Berat, për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të shtetasit Dhimitraq Ziu, gjatë periudhës 16.10.1990 - 31. 12. 1995, në shumën totale 235. 163 lekë.
- Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Berat, për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të shtetasit Dhimitraq Ziu, gjatë periudhës 1. 1. 1996 - 1.2.2001, në shumën totale 766.245 lekë.
- Vërtetim nga Ministria e Brendshme nr. *** rep., dt. 27.08.2020, për të ardhurat nga taksa e solidaritetit, realizuar nga Dhimitraq Ziu, gjatë periudhës 01.01.1999 - 01.02.2001, në shumën totale 229. 140 lekë.
- Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të shtetasit Dhimitraq Ziu, gjatë periudhës 01.02.2001 - 01.09.2003, në shumën totale 868.259 lekë.
- Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, për të ardhurat nga taksa e solidaritetit, realizuar nga Dhimitraq Ziu gjatë periudhës 01.02.2001 - 31.12.2002, në shumën totale 83.488 lekë.

- Vërtetim nga Drejtoria e Policisë Durrës, për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të shtetasit Dhimitraq Ziu, gjatë periudhës 01.09.2003 - 30.05.2004, në shumën totale 404.935 lekë.
- Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nr. *** prot., datë 12.4.2018, për Dhimitraq Ziu, i cili për periudhën 16.7.2004 - 31.7.2005 ka realizuar të ardhura nga paga dhe shpërblimet, në shumën totale prej 580.874 lekë. Të ardhurat deri në prill 2005 janë në vlerën rreth 377.000 lekë.
- Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit datë 26.12.2019 për Dhimitraq Ziu, i cili për periudhën gusht 2005 - shkurt 2016 ka realizuar të ardhura nga paga dhe shpërblimet, në shumën totale prej 8.981.309 lekë.
- Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, datë 26.12.2019 për Dhimitraq Ziu, i cili për periudhën gusht 2005 - shkurt 2016 ka realizuar të ardhura nga paga dhe shpërblimet në shumën totale prej 8.981.309 lekë.
- Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë për Dhimitraq Ziu, i cili për periudhën 10.2.2016 - 31.12.2017, ka realizuar të ardhura nga paga në shumën totale prej 2.459.348 lekë. Gjithashtu për periudhën 1.6.2004 - 16.7.2004 ka realizuar të ardhura në shumën prej 64.130 lekë.
- Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Tirane për Dhimitraq Ziu, i cili për periudhën 1.1.2018 - 4.4.2018 ka realizuar të ardhura nga paga në shumën totale prej 288.555 lekë.
- Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë për Dhimitraq Ziu, i cili për periudhën 1.4.2018 - 31.5.2021 ka realizuar të ardhura nga paga në shumën totale prej 4.333.585 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 30.12.2019, nga Komiteti Shqiptar i Birësimeve për Dhimitraq Ziu, i cili në cilësinë e anëtarit të Keshillit Drejtues të këtij institucioni, gjatë periudhës janar - dhjetor 2005 ka përfituar të ardhura neto në total 18.000 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 26.12.2019, nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi, për Dhimitraq Ziu, i cili është paguar si anëtar i këtij institucioni sipas dokumentacionit b/lidhur shkresës.
- Shkresë nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet nr. *** prot., datë 27.10.2011, për shpërblimet e anëtarëve të Komisionit, ndër të cilët shtetasi Dhimitraq Ziu është përfitues i shumës 3.500 lekë.
- Shkresë nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet nr. *** prot., datë 13.9.2012, për shpërblimet e anëtarëve të Komisionit, ndër të cilët shtetasi Dhimitraq Ziu është përfitues i shumës 14.000 lekë.
- Shkresë nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet nr. *** prot., datë 12.3.2013, për shpërblimet e anëtarëve të Komisionit, ndër të cilët shtetasi Dhimitraq Ziu është përfitues i shumës 15.000 lekë.
- Shkresë nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet nr. 3646/1 prot., datë 5.8.2013, për shpërblimet e anëtarëve të Komisionit, ndër të cilët shtetasi Dhimitraq Ziu është përfitues i shumës 7.000 lekë.
- Shkresë nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet nr. 3618/1 prot., datë 13.5.2014, për shpërblimet e anëtarëve të Komisionit, ndër të cilët shtetasi Dhimitraq Ziu është përfitues i shumës 7.000 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 5.4.2018, nga ISSH, Drejtoria Rajonale Berat, për shtetasin Jorgaq Ziu, i cili merr pension në masën mujore prej 20.545 lekë.

- Vërtetim nr. *** prot., date 18.4.2018, nga ISSH, Drejtoria Rajonale Berat për shtetasin Jorgaq Ziu, i cili merr pension në masën mujore prej 20.545 lekë. Për periudhën 4.4.1991 - 31.3.2018 ka përfituar të ardhura në shumën totale prej 3.624. 117 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 5.4.2018, nga ISSH, Drejtoria Rajonale Berat për shtetasen Evgjëni Ziu, e cila merr pension në masën mujore prej 9.802 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot., date 17.4.2018, nga ISSH, Drejtoria Rajonale Berat për shtetasen Evgjëni Ziu, e cila merr pension në masën mujore prej 9.802 lekë. Për periudhën 9.1.1987 -30.4.2018 ka përfituar të ardhura në shumën totale prej 1.436.439 lekë.
- Kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.2.2005, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Dhimitraq Ziu, Drita Ziu dhe palës blerëse S. Bode, të pasurisë së paluajtshme nr. **** loji "njësi", me sip. totale 65.5 m2, ndodhur në Berat. çmimi i shitjes 1.000.000 lekë është likuiduar totalisht ndërmjet palëve, jashtë zyrës noteriale. B/lidhur dokumentacioni ligjor i pasurisë nr.***, regjistruar në emër të Dhimitraq Ziu, Drita Ziu date 8.2.2005.
- Çertifikatë regjistrimi personit të tatueshem "Fermeri Gjergji Dhimiter Ziu" me NIPT L*****F, adresë Poshnje, Ura Vajgurore.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 19.4.2018, nga Njësia Administrative Poshnje, për Dhimitraq Ziu, i cili ka përfituar 11.310 m2 tokë bujqësore nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, në fshatin Poshnje. Nga këto, ka 2.000 m2 mbjellë me vresht dhe 2.000 m2 ullishte.
- Vërtetim datë 26.8.2020 nga Kryetari i Fshatit Poshnje, për familjen e Dhimitraq Ziu, e cila duke filluar nga viti 1991 e në vazhdim ka në pronësi tokë arë, vresht dhe ullishte, nga të cilat ka marrë prodhime bujqësore dhe i ka tregtuar.
- Fatura tatimore me palë shitëse Gjergji Ziu, dt. 31.10.2017, vlerë 30.000 lekë.
- Fatura tatimore me palë shitëse Gjergji Ziu, dt. 30.10.2017, vlerë 77.000 lekë.
- Shkresë nga Fermeri T. Ismailaj, i cili vërteton se në dt. 3.12.2017, ka blerë produkte (gjedhë) nga shtetasi Gjergji Ziu, kundrejt pagesës 200.000 lekë.
- Kontratë shitblerje për automjete datë 18.01.2022, palë shitëse Dhimitraq Ziu e Gjergji Ziu, palë blerëse "Auto Almet" shpk, të automjetit Mercedes Benz E200, kundrejt vlerës 842.000 lekë. B/lidhur fatura e blerjes së automjetit.
- Kontratë shitje mjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.11.2016, palës shitëse Dhimitraq Ziu dhe palë blerëse E. Gjoka, të automjetit Mercedes Benz, me targë T*****P, kundrejt vlerës 500.000 lekë.
- Kontratë shitje mjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.3.2008, palës shitëse Dhimitraq Ziu dhe palë blerëse A. Dervishi, të automjetit Mercedes Benz, me targë T*****K, kundrejt vlerës 580.000 lekë.
- Kontratë shitje automjeti datë 20.11.2000, palë shitëse Dhimitraq Ziu dhe palë blerëse I. Z, të automjetit Fiat, kundrejt shumës 200.000 lekë.
- Kontratë qiraje (pasuri të paluajtshme) nr.*** rep., nr. *** kol., datë 27.4.2022, palë qiradhënëse Dhimiter Ziu e Drita Ziu, palë qiramarrëse I. D, të pasurisë "njësi" me nr.****, sip. totale 13.7 m2, ndodhur në Berat. Afati i qirasë 3 vjet. Vlera e qirasë 18.000 lekë/muaj. Qiramarrësi merr përsipër të paguajë të gjitha detyrimet fiskale, të cilat përfshijnë taksën vendore të pasurisë si dhe tatimin në burim nga të ardhurat e qirasë.
- Kontratë qiraje (pasuri të paluajtshme) nr. *** rep., nr.*** kol., date 12.9.2020, palë qiradhënëse Dhimiter Ziu e Drita Ziu, palë qiramarrëse I.D, të pasurisë

"njësi" me nr.***, sip. totale 13.7 m2, ndodhur në lagjen "30 Vjetori" Berat. Afati i qirasë 2 vjet, i cili ka filluar në 4.4.2020 deri në datë 3.4.2022. Vlera e qirasë 18.000 lekë/muaj. Qiramarrësi merr përsipër të paguajë të gjitha detyrimet fiskale, të cilat përfshijnë taksën vendore të pasurisë, si dhe tatimin në burim nga të ardhurat e qirasë.

- Kontratë qiraje (pasuri të paluajtshme) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.4.2018, palë qiradhënëse Dhimitër Ziu e Drita Ziu, palë qiramarrëse I.D, të pasurisë "njësi" me nr. ****, sip. totale 13.7 m2, ndodhur në Berat. Afati i qirasë 2 vjet, deri në datë 3.4.2020. Vlera e qirasë 18.000 lekë/muaj. Qiramarrësi merr përsipër të paguajë të gjitha detyrimet fiskale, e cila përfshin taksën vendore të pasurisë si dhe tatimin në burim nga të ardhurat e qirasë.
- Kontratë qiraje (pasuri të paluajtshme) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.4.2015, palë qiradhënëse Dhimitër Ziu e Drita Ziu, palë qiramarrëse I.D, të pasurisë "njësi" me nr.***, sip. totale 13.7 m2, ndodhur në lagjen "30 Vjetori" Berat. Afati i qirasë 3 vjet, deri në datë 04.04.2018. Vlera e qirasë 5000 lekë/muaj.
- Kontratë qiraje (pasuri të paluajtshme) nr. 4982 rep., nr. 1605 kol., datë 4.12.2009, palë qiradhënëse Dhimitër Ziu e Drita Ziu, palë qiramarrëse I.C të pasurisë "njësi" me nr.****, sip. totale 13 m2, ndodhur në Berat. Afati i qirasë 1 vit, deri në datë 31.12.2010. Vlera e qirasë 5.000 lekë/muaj. Nuk përcaktohet likuidimi i detyrimit të tatimit në burim.
- Deklaratë noteriale nr.*** rep., nr. 331 kol., datë 28.04.2018, deklarues Llazar Karabina, i cili deklaroi se ka pasur një marrëdhënie qiraje për një njësi shërbimi në pronësi të Dhimitraq Ziu, në të cilën ka punuar si mjek stomatolog, me Nipt K*****A. Marrëdhënia ka filluar më 1.10.2004 deri në 1.2.2009. Qiraja mujore ka qenë në vlerën 20.000 lekë. Në momentin e lidhjes së kësaj kontrate qiraje, nuk kanë kryer akt noterial, pasi nuk kanë pasur detyrim ligjor. Bashkelidhur:
 1. Kontratë dhënie ambienti me qira (përpiluar me shkrim dore) datë 1.6.2008 me palë qiradhënëse Dhimitraq Ziu dhe palë qiramarrëse Ll.K, të një njësie regjistruar me nr.*****, Berat. Afati i qirasë nga data 1.6.2008 deri në datë 1.2.2009. Masa e qirasë do të jetë 20.000 lekë/muaj.
 2. Kontratë dhënie ambienti me qira (përpiluar me shkrim dore) datë 1.7.2007 me palë qiradhënëse Dhimitraq Ziu dhe palë qiramarrëse Ll. K, të një njësie regjistruar me nr. ***** Berat. Afati i qirasë nga data 1.7.2007 deri në datë 1.6.2008. Masa e qirasë do të jetë 20.000 lekë/muaj.
 3. Kontratë dhënie ambienti me qira (përpiluar me shkrim dore) datë 1.8.2006 me palë qiradhënëse Dhimitraq Ziu dhe palë qiramarrëse Llazar Karabina, të një njësie regjistruar me nr. 15/7 ZK 8502, lagjja "30 Vjetori" Berat. Afati i qirasë nga data 1.8.2006 deri në datë 1.7.2007. Masa e qirasë do të jetë 20.000 lekë/muaj.
 4. Kontratë dhënie ambienti me qira (përpiluar me shkrim dore) datë 1.9.2005 me palë qiradhënëse Dhimitraq Ziu dhe palë qiramarrëse Ll. K, të një njësie regjistruar me nr. ***** Berat. Afati i qirasë nga data 1.9.2005 deri në datë 1.8.2006. Masa e qirasë do të jetë 20.000 lekë/muaj.
 5. Kontratë dhënie ambienti me qira (përpiluar me shkrim dore) datë 1. 10.2004 me palë qiradhënëse Dhimitraq Ziu dhe palë qiramarrëse Ll. K, të një njësie regjistruar me nr.

*****, Berat. Afati i qirasë nga data 1.10.2004 deri në datë 1.9.2005. Masa e qirasë do të jetë 20.000 lekë/muaj.

6. Kontratë qiraje (pasuri të paluajtshme) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.12.2022, palë qiradhënëse Dhimitër Ziu e Drita Ziu, palë qiramarrëse Xh. T te pasurisë "njësi" me nr.****, sip. totale 14.8 m2, ndodhur në Berat. Afati i qirasë 2 vjet, periudha 1.1.2023 - 1. 1.2025. Vlera e qirasë 20.000 lekë/muaj.
 7. Kontratë qiraje (pasuri të paluajtshme) nr. *** rep. nr. *** kol. datë 16.12.2021, palë qiradhënëse Dhimiter Ziu e Drita Ziu, palë qiramarrëse Nj.P të pasurisë "njësi" me nr.****, sip. totale 14.8 m2, ndodhur në Berat. Afati i qirasë 2 vjet, periudha 1.11.2021 - 1.11.2023. Vlera e qirasë 18.000 lekë/muaj.
 8. Kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2. 11.2019, palë qiradhënëse Dhimitër Ziu e Drita Ziu, palë qiramarrëse Nj. P të pasurisë "njësi" me nr.***, sip. totale 14.8 m2, ndodhur në Berat. Afati i qirasë 2 vjet, periudha 1.11.2019 - 1.11.2021. Vlera e qirasë 18.000 lekë/muaj.
 9. Kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.10.2017, palë qiradhënëse Dhimitër Ziu e Drita Ziu, palë qiramarrëse Nj. P të pasurisë "njësi" me nr.***, sip. totale 14.8 m2, ndodhur në Berat. Nga pasuria e mësipërme, jepet me qira një ambient me sip. prej 10.2 m2. Afati i qirasë 2 vjet, periudha 1. 11.2017 - 1.11.2019. Vlera e qirasë 18.000 lekë/muaj.
- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.4.2018, deklarues Dhimitër Ziu dhe Nj. P, të cilët deklarojnë se kanë lidhur kontratën e qirasë nr. *** rep. nr. *** kol., datë 28.10.2017. Gjatë redaktimit të kontratës së qirasë është regjistruar gabim numri i pasurisë së njësisë, si dhe sipërfaqja e saj, prandaj me anë të deklaratës palët saktësojnë se pasuria e lëshuar me qira ka këto tregues: pasuria "njësi", regjistruar me nr.****, me sip. totale 14.8 m2.
 - Kontratë qiraje nr. ****rep., nr.**** kol., datë 9.10.2015, palë qiradhënëse Dhimitër Ziu e Drita Ziu, palë qiramarrëse L. Gj të pasurisë "njësi" me nr.***, sip. totale 14.8 m2, ndodhur në Berat. Afati i qirasë 3 vjet, periudha 1.10.2015 - 1.10.2018. Vlera e qirasë 5.000 lekë/muaj.
 - Kontratë qiraje nr. ****rep., nr. **kol., datë 10.1.2012, palë qiradhënëse Dhimitër Ziu, palë qiramarrëse A. C, të pasurisë "apartament" me nr.****, ndodhur në Berat. Nga pasuria e mësipërme, jepet me qira një ambient me sip. Prej 9 m2. Afati i qirasë 1 vit, periudha 1.1.2012 - 31.12.2012. Vlera e qirasë 5.000 lekë/muaj.
 - Kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.1.2011, palë qiradhënëse Dhimitër Ziu, palë qiramarrëse P.L, të pasurisë "apartament" me nr. ****, ndodhur në Berat. Nga pasuria e mësipërme, jepet me qira një ambient me sip. prej 9 m2. Kontrata është e lidhur pa afat, duke filluar nga data 3.1.2011 dhe do përfundojë në çdo kohë me pëlqim të palëve. Vlera e qirasë 10.000 lekë/muaj.
 - Kontratë qiraje nr. **rep., nr. ** kol., datë 7.1.2010, palë qiradhënëse Dhimitër Ziu, palë qiramarrëse P.L, të pasurisë "apartament" me nr. ****, ndodhur në Berat. Nga pasuria e mësipërme, jepet me qira një ambient me sip. prej 9 m2. Afati i qirasë 1 vit, periudha 1.1.2010 - 31.12.2010. Vlera e qirasë 10.000 lekë/muaj.

- Kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2007, palë qiradhënëse Dhimitër Ziu, palë qiramarrëse V.Z, të pasurisë "apartament" me nr.*** , ndodhur në Berat. Nga pasuria e mësipërme, jepet me qira një ambient me sip. prej 9 m2. Afati i qirasë 5 vjet, periudha 1.10.2007 - 30.9.2012. Vlera e qirasë 20.000 lekë/muaj.
- Kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.12.2021, palë qiradhënëse Dhimitër Ziu, Drita Ziu dhe palë qiramarrëse V. Z, të pasurisë së paluajtshme me nr.*** , ndodhur në Berat. Pala qiramarrëse merr me qira sipërfaqen prej 30 m2. Afati i qirasë 2 vjet, periudha 1.11.2021 - 1.11.2023. Vlera e qirasë 10.000 lekë/muaj. Pala qiramarrëse detyrohet të paguajë tatimin në burim për pasurinë e marrë me qira.
- Kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2. 11.2019, palë qiradhënëse Dhimitër Ziu dhe palë qiramarrëse V. Z, të pasurisë së paluajtshme e regjistruar me nr. hipotekor 635, pranë ASHK Berat. Pala qiramarrëse merr me qira sipërfaqen prej 30 m2. Afati i qirase 2 vjet, periudha 1.11.2019 - 1.11.2021. Vlera e qirase 10.000 lekë/muaj. Pala qiramarrëse detyrohet të paguajë tatimin në burim për pasurinë e marrë me qira.
- Kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.10.2014, palë qiradhënëse Dhimitër Ziu dhe palë qiramarrëse V. Z të pasurisë së paluajtshme "Garazh + Truall" ndodhur në Berat, me sip. gjithsej 30 m2, e regjistruar me nr. Hipotekor *** , pranë ASHK Berat. Pala qiramarrëse merr me qira gjithë sipërfaqen prej 30 m2. Afati i qirasë 5 vjet, periudha 1.10.2014 - 30.9.2019. Vlera e qirasë 2.000 lekë/muaj.
- Kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2011, palë qiradhënëse Dhimitër Ziu dhe palë qiramarrëse V. Z të pasurisë së paluajtshme "Garazh + Truall" ndodhur në Berat, me sip. gjithsej 30 m2, e regjistruar me nr. hipotekor***, pranë ASHK Berat. Pala qiramarrëse merr me qira gjithë sipërfaqen prej 30 m2. Afati i qirasë 3 vjet, periudha 6.3.2011 - 6.3.2014. Vlera e qirasë 2.000 lekë/muaj.
- Kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.3.2008, palë qiradhënëse Dhimitër Ziu dhe palë qiramarrëse V. Z, të pasurisë së paluajtshme "Garazh + Truall" i ndodhur në Berat, me sip. gjithsej 30 m2, e regjistruar me nr. hipotekor *** , pranë ASHK Berat. Pala qiramarrëse merr me qira gjithë sipërfaqen prej 30 m2. Afati i qirasë 3 vet, periudha 5.3.2008 - 5.3.2011. Vlera e qirasë 10.000 lekë/muaj.
- Kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.4. 1999, palë qiradhënëse Dhimitër Ziu dhe palë qiramarrëse L. Sh të një dyqani ndodhur në Berat, kundrejt një qiraje mujore prej 11.500 lekë për tre muaj dhe pas kësaj periudhe për një kohë prej 21 muajsh, kundrejt një qiraje prej 13.000 lekë. Qiradhënësi do të paguajë të gjitha detyrimet shtetërore për të ardhurat nga qiraja.
- Deklaratë (me shkrim dore) e shtetasit P. P i cili deklaroi se ka marrë me qira nga Dhimitër Ziu objektin me nr. pasurie *** ndodhur në Berat gjatë periudhës 19.7.2002-30.6.2005, kundrejt një qiraje prej 20.000 lekë/muaj. Marrja me qira e objektit është bërë në bazë të

kontratës së qirasë nr. *** rep. nr. *** kol. datë 19.7.2002, sipas vërtetimit të datës 25.4.2018 të lëshuar nga noteri I. I.

- Vërtetim datë 25.4.2018 nga Dhoma e Noterëve Vlorë, Noter I. I Berat, i cili deklaron se në bazë të kërkesës së bërë nga shtetasi Dhimitraq Ziu, përta i përket nxjerrjes së kopjeve nga arkiva noteriale që disponon, rezulton se është nënshkruar kontrata e qiradhënies nr. *** rep. nr. *** kol. datë 19.7.2002, me palë qiradhënëse Dhimitraq Ziu dhe palë qiramarrëse P. P.

Tabelë përmbledhëse e të ardhurave sipas kontratave të qirasë, përlogaritur nga subjekti

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

- Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** dt. 8.5.2023 konfirmon llogarinë e pagës në emër të shtetasit Dhimitraq Ziu dhe pagat e kreditura gjatë periudhës 4.5.2005 - 13.12.2010, në vlerën totale prej rreth 4.656.000 lekë.
- Tirana Bank, me shkresën nr.***, dt. 8.5.2023 konfirmon llogari në emër të Dhimitraq Ziu, në të cilën janë kredituar para gjatë periudhës 6.1.2011 - 2.3.2023, në total rreth 15.103.000 lekë.
- ISSH, me shkresën nr.***prot., datë 12.5.2023, konfirmon se Dhimitraq Ziu ka realizuar të ardhura gjatë periudhës: dhjetor 2012 - shkurt 2016 dhe korrik - tetor 2021, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, shkurt 2016 - shtator 2021, pranë Drejtorisë së Policisë; nëntor 2021 - shtator 2022, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës; tetor 2022 - mars 2023, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Dibrë.
- Gjithashtu, konfirmohet se shtetasit: Jorgaq Ziu, nga prill 1991 përfiton pension pleqërie me masë mujore aktuale 24.868 lekë dhe Evgjëni Ziu, nga janar 1987 përfiton pension pleqërie me masë mujore aktuale 11.726 lekë.
- ISSH, me shkresën nr. *** prot., datë 17.5.2023, konfirmon periudhën e punësimit të shtetasit Jorgaq Ziu, gjatë viteve 1953 - 1989, në Kooperativen Bujqësore Poshnje.
- DRT Berat, me shkresën nr. *** prot., datë 05.05.2023, lidhur me të ardhurat e përfituara nga qiraja dhe detyrimet tatimore që rrjedhin prej tyre, për individët (tatimpagues, të cilët rezultojnë qiramarrës të pasurive të shtetasit Dhimitraq Ziu, rezulton se:
- Tatimpaguesi I. D ka paguar tatim në burim (për qiranë), periudha prill 2015-mars 2023, vlerën prej 177.390 lekë.
- Tatimpagëse Nj. P, ka paguar tatim në burim (për qiranë), periudha nëntor 2017 - mars 2023, vlerën prej 146.250 lekë.
- Tatimpagues L. Gj, ka paguar tatim në burim (për qiranë), periudha tetor 2015 - tetor 2018, vlerën prej 40.950 lekë.

- Tatimpaguesi V. Z ka paguar tatim në burim (për qiranë), periudha dhjetor 2014 - shtator 2019 vlerën prej 18.000 lekë; nëntor 2019 - tetor 2021, vlerën prej 36.000 lekë dhe nëntor 2021 - mars 2023, vlerën 22.500 lekë.
 - Tatimpagues I. C, me NIPT K*****R, nuk ka përgjegjësinë tatimore për deklarim të tatimit në burim.
 - Tatimpaguesi L. K, me NIPT K*****A, nuk ka përgjegjësinë tatimore për deklarim të tatimit në burim.
 - Tatimpaguesi A. C, me Nipt K*****G, për periudhën janar - dhjetor 2012 nuk ka pasur përgjegjësinë tatimore për deklarim dhe pagesë të tatimit në burim për qiranë.
 - Tatimpaguesi Plarent Lapardhaja, me Nipt L03420001A, për periudhën janar 2011- dhjetor 2012, nuk ka pasur përgjegjësinë tatimore për deklarim dhe pagesë të tatimit në burim për qiranë.
 - Individët Ll. P dhe Ll. Sh nuk rezultojnë të jenë regjistruar si tatimpagues në DRT Berat.
- Në proces verbalet e datës 3.7.2023 dhe 13.10.2023, subjekti sqaroi se të gjitha ambientet e lëshuara me qira prej tij, kanë kryer aktivitet biznesi, ku ai si qiradhënes ka kryer pagesën për tatimin në burim për kontratën nr.*****, dt. 3.4.1999, detyrim i përcaktuar në këtë kontratë. Mandat pagesat ia ka dorëzuar qiramarrësit i cili mbante në dosjen e aktivitetit që kontrollohej nga Inspektorati Tatimor. Për të gjitha kontratat e mëvonshme, tatimi në burim është paguar nga qiramarrësit që ushtrojnë bizneset e tyre, detyrim i përcaktuar në kontratat e nënshkruara ndërmjet palëve. Nuk ka nënshkruar kontrata anuluese, ndërprerja e marrëdhënieve është kryer verbalisht.
- Kontratat nr. ***** dt. 03.04.1999, nr.*****, dt. 19.7.2002 - 24.3.2003, janë bërë për ambjentin *****(para ndarjes).
- Kontrata *****dt. 10.1.2012, i përket pasurisë*****.
- Kontrata *****dt. 19.1.2011, i përket pasurisë *****.
- Kontrata *****dt. 2.10.2007, i përket pasurisë *****.
- Këto kontrata i përkasin pasurisë nr. *****pas ndarjes, por në to është shënuar nr. i pasurisë para ndarjes (lapsus i noterit pasi në këtë periudhë objektet kanë qenë të ndara, ndërkohë që është punuar në kontratat ekzistuese të mëparëshme). Pasuria *****është pjesë e pasurisë *****.
- Të ardhurat e deklaruara 200.000 leke nga shitja e pjesës takuese të pandarë të banesës me sip. 94 m2, Berat, i ka deklaruar si të ardhura brenda familjes, në kushtet kur këto të ardhura janë përfituar nga prindërit e tij. Prindërit, gjithë kohën kanë qenë pjesë e familjes së tij dhe sot vazhdojnë të jenë nën kujdestarinë e tij. Juridikisht familja e tij, deri në dt. 08.02.2012, përbëhet nga 6 persona (bashkë me prindërit). Në datën 9.2.2012 kanë bërë ndarje familjare me prindërit. Prindërit kanë jetuar me të në Berat dhe sot jetojnë në Poshnjë, pasuria nr.*****. Për këtë arsye ai i ka përfshirë të ardhurat e tyre në deklaratën e pasurisë.

- Vlera e deklaruar 4.300.000 lekë, si e ardhur nga veprimtaria bujqësore dhe blektorale që nga viti 1991 e deri në vitin 2018, është bazuar në sasi të produkteve bujqësore dhe blektorale dhe kostot mesatare, referuar periudhave përkatëse të deklaruara. Familja e tij nga viti 1999 e në vazhdim ka përdorur tokën bujqësore dhe ka prodhuar rregullisht produkte bujqësore dhe blektorale duke tregëtuar prej tyre. Kjo vërtetohet me aktet e pronësisë së tokës dhe vërtetimet e Njesisë Administrative Poshnje. Djali prej vitit 2017 është regjistruar si Fermer duke evidentuar aktivitetin e tij tregtar, nëpërmjet faturave tatimore. Nuk disponon dokumentacion tjetër përveç atij të paraqitur.

Në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

- Të ardhurat e subjektit nga paga, shpërblimet, për periudhën 1986 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 22.760.000 lekë.
- Të ardhurat nga qiraja, për periudhën 1999 - mars 2023, deklarohen nga subjekti në vlerën 6.220.000 lekë, të konfirmuara me deklarata noteriale. DRT konfirmon pagesën e detyrimeve tatimore, për vlerën e përfituar të të ardhurave prej rreth 2.900.000 lekë, pavarësisht se në kontratat e paraqitura detyrimi ka qenë i palës qiramarrëse, e cila në të gjitha rastet ka zhvilluar aktivitet biznesi.
- Të ardhura neto nga shitja në v. 2004, të apartamentit/njesisë, me sip. 65.5 m2, Berat, në shumën rreth 800.000 lekë (blerë 200.000 lekë/shitur 1.000.000 lekë).
- Të ardhurat nga veprimtaria bujqësore dhe blektorale, për periudhën 1991 - 2018. deklaruar nga subjekti në shumën totale 4.300.000 lekë, nuk janë dokumentuar dhe nuk janë konfirmuar nga institucionet tatimore. Subjekti ka paraqitur dokumenta pronësie të tokës bujqësore, përfituar me ligin 7501.

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

1. Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur - PERIUDHA 1.1.2022 - 31.12.2022.

Subjekti deklaron:

1. Shpenzime telefoni Dhimitraq Ziu. Shuma 13.878 lekë.
2. Shpenzime telefoni Drita Ziu. Shuma 7.200 lekë.
3. Shpenzime telefoni Gjergj Ziu. Shuma 20.534 lekë.
4. Shpenzime telefoni Marinela Ziu. Shuma 16.613 lekë.
5. Telefon fiks+ internet Dhimitraq Ziu. Shuma 22. 156 lekë.
6. Shpenzime uji, Dhimitraq Ziu. Shuma 34.888 lekë.
7. Shpenzime për drita, Dhimitraq Ziu. Shuma 121.334 lekë.
8. Ashensor + shpenzime të përbashkëta. Shuma 18.000 lekë.

Dokumentacioni bashkëlidhur:

- Librezë OSHEE, nr.****, në emër të Dhimitraq Ziu, periudha janar 2022 - janar 2023. Vlera e paguar gjithsej rreth 120.000 lekë.
- Librezë OSHEE në Poshnje, kontrata në emër të Jorgaq Ziu nr. ***** periudha janar - qershor 2019 dhe janar 2022 - janar 2023, me vlerë të paguar në shumën 42.400 lekë.
- Librezë OSHEE në emër të Dhimitraq Ziu, kontratë nr.*****, periudha janar 2022- janar 2023.
- Librezë OSHEE në emër të Dhimitraq Ziu, kontratë nr. *****, periudha janar 2022 janar 2023.
- Librezë OSHEE në emër të Dhimitraq Ziu, kontratë nr.*****, periudha janar 2022 janar 2023.
- Librezë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë, në emër të Dhimitraq Ziu, kontrata*****, periudha janar 2022 - janar 2023.
- Librezë telefoni në emër të Dhimitraq Ziu, periudha shkurt 2019 - janar 2023 (nr. ...825). Vlera totale e paguar rreth 22.000 lekë.
- Librezë Ujësjiellës Kanalizime Poshnje, në emër të Jorgaq Ziu, kontrata**, periudha janar 2022 - janar 2023. Vlera e paguar 3.750 lekë.
- Librezë telefoni në emër të Jorgo Ziu (nr. ..***), periudha janar 2021 - janar 2023. Vlera e paguar në total 8.400 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

- FSHU, me shkresën nr. *** prot., datë 17.5.2023, konfirmon se në emër të Dhimitraq Jorgaq Ziu, figurojnë të regjistruar dy abonentë me kontratë furnizimi nr. B*****2 dhe nr. B*****7, në instancë Berat. Gjithashtu, me gjeneralitetet Dhimitraq Ziu, figuron i regjistruar një abonent me nr. T*****7, në instancën Tiranë.
- Shoqëria Rajonale Ujësjiellës - Kanalizime Tiranë, me shkresën nr. ***** prot., datë 24.5.2023, konfirmon se në emër të Dhimitraq Ziu, rezulton kontrata nr. ***** për objektin me adresë në Tiranë me status "aktiv" në kategorinë e konsumatorëve familjare, me detyrime të likuiduara deri në muajin mars 2023.
- B/lidhur certifikata për vërtetim pronësie të pasurisë nr.*****. Vlera e faturuar për periudhën janar - dhjetor 2022, me total rreth 35.000 lekë.
- Shoqëria Rajonale Ujësjiellës - Kanalizime Berat, me shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2023, nuk konfirmon kontrata furnizimi me ujë në emër të Dhimitraq Jorgaq Ziu dhe personave të lidhur me të.
- 12 Shoqëritë Rajonale të Ujësjiellës - Kanalizime, me shkresat nr. ***** prot. dhe ***prot., nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- Vodafone Albania sh.a, me shkresën nr.***, dt. 16.6.2023, konfirmon se në emër të shtetasit Drejtoria e Përgjithshme e Policisë (Dhimitraq Ziu) figurojnë 3 numra aktiv;

nr...076 datë aktivizimi 11.12.2007, nr...249 datë aktivizimi 25.2.2016, nr. ..556 datë aktivizimi 7.3.2016, shpenzimi i të cilave gjatë periudhës 1.1.2022 - 31.12.2022 është në vlerën totale prej 21.600 lekë.

- Shtetasit Gjergji Ziu i korrespondon një numër telefoni ...311, aktivizuar prej 22.12.2014. Vlera e shpenzuar për vitin 2022 gjithsej 18.750 lekë. Shetases Marinela Ziu i korrespondon një numër telefoni089, aktivizuar prej 4.11.2015. Vlera e shpenzuar për vitin 2022 gjithsej 14.000 lekë.
- One Albania sh.a, me shkresën nr. 21/49, dt. 31.5.2023, konfirmon se në emër të shtetasit Dhimitraq Jorgaq Ziu, figurojnë 2 numra fiks (nr...825 dhe nr... 173), shpenzimi i të cilave gjatë periudhës 1. 1.2022 - 31. 12.2022 është në vlerën totale prej 35.516 lekë.
- Albania Satellite Communications shpk, me shkresën nr. *** prot., dt. 15.5.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- Abissnet sh.a, me shkresën nr. *** prot. dt. 11.5.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- Digicom sh.a, me shkresën nr. *** prot. dt. 12.5.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- Në proces verbalin e datës 13.10.2023, subjekti sqaroi se përsa i përket kontratës së konfirmuar nga One Albania, në emër të Dhimitraq Ziu, me nr. + 322..173, ky telefon është përdorur prej tij deri në vitin 2004. Pasi u largua nga qyteti i Beratit, atë e përdor vëllai i tij V. Ziu, por nga kompania nuk është kryer ndryshimi i përdoruesit. Shpenzimet janë paguar rregullisht prej vëllait. Sapo ka marrë dijeni për këtë konfirmim, ka kryer veprimet e ndryshimit të kontratës në emër të vëllait.

Subjekti paraqiti:

- Kontratën e telefonit (nr.***) nënshkruar pranë kompanisë One Albania, në emër të V. Ziu dt.11.10.2023.

Shpenzimet e deklaruar për ujë + drita + telefoni + internet gjatë periudhës së sipërcituar, me kontrata në emër të subjektit dhe/apo personave të lidhur me të, rezultojnë në total rreth 250.000 lekë.

2. Udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit. kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara:

Subjekti deklaron:

- **Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022** Shpenzime udhëtimi. Shuma totale 720 euro. Udhëtim 11 - 15 tetor 2021, Dhimitraq Ziu, vizitë studimore ne Pragë me shpenzimet e pritësve, shuma 200 euro; Udhëtim 26.11.2021, Drita Ziu vizitë një ditore Shën Naum, Maqedoni, shuma 20euro. Udhëtim 22.7.2022, vizite një ditore me familjen ne Janine, shuma 200 euro. Udhëtim 30.1.2022 - 13.2.2022, Gjergji Ziu në Turqi, trajnim në Universitetin e Ankarasë, shuma 200 euro. Shpenzimet e akomodimit dhe të tjera nga Universiteti Aldent. Udhëtim 18.2.2023, Dhimitraq Ziu dhe Drita Ziu, vizitë një ditore në Dibër e Madhe, Maqedoni, shuma 100 euro.

Dokumentacioni bashkëlidhur:

1. Ftesë pjesëmarrje nga Universiteti i Ankarasë për studentin Gjergji Ziu, periudha 31.1.2022 - 16.2.2022.
 2. Në proces-verbalin e datës 3.7.2023. subjekti paraqiti.: Urdhër nr. 884 prot., datë 23.9.2021, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për caktimin e kryerjes së shërbimeve jashtë shtetit (Republikën Çeke) gjatë periudhës 11 - 15 tetor 2021, pjesë e së cilit ishte punonjësi Dhimitraq Ziu.
 3. Konfirmim nga sistemi TIMS, për subjektin dhe familjarët e tij, ku vërtetohen lëvizjet.
- ✓ ***Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar sa i përket hyrje-daljeve nga RSH, gjatë periudhës 2020 - 2022, të subjektit dhe personave të lidhur me të.***
- ✓ ***Shpenzimet e deklaruar për udhëtimet private, personale dhe të personave të lidhur, gjatë periudhës së sipërcituar, rezultojnë në total rreth 720 euro, konvertuar rreth 83.000 lekë.***
3. Për arsimimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, apo të personave të lidhur , duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar. Periudha nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë.

Subjekti deklaron:

- Shpenzime arsimimi. Shuma totale 43.900 euro.:
 1. Djali Gjergji Ziu në Universitetin "Aldent" gjatë 5 viteve 2011 - 2015, shuma 17.500 euro.
 2. Vajza Marinela Ziu në Universitetin "Aldent" gjatë 5 viteve 2016 - 2020, shuma 17.400 euro.
 3. Specializim djali Gjergji Ziu, në Universitetin "Aldent" gjatë 3 viteve 2020 - 2022, shuma 9.000 euro.

Dokumentacioni bashkëlidhur:

- Vërtetim nr. 1407 prot., datë 27.2.2023, nga Universiteti "Aldent" për Marinela Ziu, e cila ka kryer studimet në programin Master, për ciklin akademik 2016 - 2021. Studentja ka shlyer të gjitha detyrimet financiare; dt. 14.12.2016 shuma 3.600 euro; dt. 22.11.2017 shuma 3.600 euro; dt. 16.11.2018 shuma 3.600 euro; dt. 18.12.2019 shuma 3.500 euro; dt. 30. 12.2020 shuma 3. 100 euro.
- Mandatet e pagesave në BKT nga Gjergji Ziu, në favor të "Aldent" shpk, dt.30.10.2020, shuma 2.500 euro; dt. 29.12.2022, shuma 3.000 euro; dt. 9.11.2021, shuma 3.000 euro; dt. 17.02.2020, shuma 500 euro, përshkrim "pagesë për specializim kirurgji orale.

Konkluzione:

- ✓ *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.*
- ✓ *Shpenzimet e deklaruara dhe të dokumentuara për arsimimin e personave të lidhur (fëmijëve) gjatë periudhës 2011 - 2022, rezultojnë në total rreth 43.900 euro, konvertuar rreth 5.000.000 lekë, me burim kursimet nga pagat dhe të ardhurat e tjera të përmendura më sipër ndër vite.*

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES –DRITA ZIU

DEKLARIMI I PASURISË

- Gjendje në llogarinë e pagës pranë Raiffeisen Bank, dt. 1.3.2023. Vlera 1.857.289 lekë. Pjesë takuese 100%. Burimi i krijimit: kursime nga paga 2017 - 2023.

Dokumentacioni bashkëlidhur:

- Lëvizjet e Ilogarisë në emër të Drita Ziu, në Raiffeisen Bank, gjatë periudhës 1.1.2023 - 3.3.2023. Gjendje në Ilogari datë 3.3.2023, në vlerën 1.915.236 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

RFZ Bank me shkresën nr.***, cit. 8.5.2023, konfirmon se shtetasja Drita Ziu disponon Ilogari page me gjendje në dt. 8.3.2023, vlerën 1.970.236 lekë. B/lidhur lëvizjet e Ilogarisë në të cilën evidentohet se Ilogaria është kredituar nga pagat, prej ri-çeljes së Ilogarisë në vitin 2017, ku gjendja fillestare e së cilës ishte akumuluar në vlerën 150.000 lekë dt. 31.12.2017 dhe është shtuar/pakësuar ndër vite.

Konstatohet se: Ilogaria është krijuar gjatë periudhës 2017 - 2023.

B/shortia deklaron gjendjen e Ilogarisë në ' RFZ Bank, dt. 1.3.2023, ndërsa konfirmimi i bankës është i datës 8.3.2023.

- Depozitë me afat në Credins Bank, krijuar në 09.03.2018. Mbyllur dhe tërhequr e gjithë shuma në Ilogari në datën 14.10.2022. Gjendje datë 01.03.2023 në vlerën 0 lekë.

Dokumentacioni bashkëlidhur:

- Mandat tërheqje cash në dt. 14.10.2022, Drita Ziu tërheq në Credins Bank shumën 408.308 lekë. Credins Bank me shkresën nr. ***, dt. 30.05.2023, konfirmon depozitën në emër të Drita Ziu, me gjendje për periudhën 2018 — 2021, në vlerën 400.000 lekë dhe me status "mbyllur" në vitin 2022. Evidentohet tërheqja cash nga Ilogaria e pagës dt. 13.10.2017, në vlerën 390.759 lekë, depozitimi 400.000 lekë në Ilogari rrjedhëse dt. 09.03.2018 dhe transferimi i vlerës në depozitë me afat. Shuma është tërhequr cash në dt. 14. 10. 2022, në vlerën 408.300 lekë.
- ✓ ***Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Credins Bank. Depozita është mbyllur.***
- Fond pensioni "Sicred Pensions", krijuar 2015 - 2017. Gjendje më 28.2.2023 gjithsej 36.916 lekë. Vlera 29.000 lekë. Zotëron 100%. Burimi i krijimit: kursime nga paga 2015-2017.

Dokumentacioni bashkëlidhur:

- Kontratë e anëtarësimit në fondin e pensionit vullnetar në SiCred Pension, nënshkruar nga Drita Ziu, në datë 09.06.2015. Shuma e kontributit mujor në vlerën 1.000 lekë.
- Certifikata e pronësisë së kuotave në emër të Drita Ziu, pranë Credins Bank. Shuma totale e kuotave në dt. 28.02.2023, në vlerën 36.916 lekë. Blerë kuota gjatë periudhës 10.06.2015 - 28.02.2023, në total 29.000 lekë.
- **Credins Invest** me shkresën nr.***, dt. 8.5.2023, konfirmon se shtetasja Drita Ziu është kliente prej datës 10.06.2015, në Fondin e Pensionit Credins. Vlera e fondit në dt. 08.03.2023 në shumën 36.949 lekë.
- ✓ ***Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Credins Invest.***

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura nga paga në Kooperativën Bujqësore Seman, për periudhën 1989 - 1991. Shuma e të ardhurave 15.386 lekë.
- Të ardhura nga pagesë papunësie për periudhën 1991-1993. Shuma e të ardhurave 11.693 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë e Shëndetësisë Berat, për periudhën 1993 - 2004. Shuma e të ardhurave 1.349.323 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për periudhën 2005 - prill 2008. Shuma e të ardhurave 645.038 lekë.

- Të ardhura nga paga në Entin Kombëtar të Banesave për periudhën prill 2008 - shtator 2017. Shuma e të ardhurave 5.897.658 lekë.
- Të ardhura nga paga në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, për periudhën shtator 2017 - 2018. Shuma e të ardhurave 906.325 lekë.
- Të ardhura nga paga në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, për periudhën 1.1.2019 - 1.6.2021. Shuma e të ardhurave 1.677.586 lekë.
- Të ardhura nga paga + dieta në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, për periudhën 1.6.2021 - 31.12.2022. Shuma e të ardhurave 1.912.903 lekë.
- Të ardhura nga paga + dieta në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, për periudhën 1.1.2023 - 1.3.2023. Shuma e të ardhurave 176.694 lekë.

Dokumentacioni bashkëlidhur

- Vërtetim nr. *** prot., datë 25.8.2020, nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Berat, për Drita Rina, e cila është trajtuar për peridhën 1.12.1990 - 1.9.1992 me pagesë papunësie; nga 1.9.1992 - 15.2.1993 është trajtuar me leje lindje dhe për periudhën 15.2.1993 - 15.4.1993, është trajtuar përsëri me pagesë papunësie me vlerën l. 063 lekë/muaj. B/lidhur ndodhet libeze pune në emër të Drita Rina.
- Vërtetim nga DRSSH Berat për Drita Ziu, e cila ka realizuar të ardhura gjatë periudhës shtator 1993 - shtator 2004, në shumën totale 1.349.323 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 13.4.2018, nga Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Berat për Drita Ziu dhe të ardhurat e realizuara për periudhën l. 1.2005 -prill 2008. Shuma totale e të ardhurave neto 645.038 lekë (për periudhën janar -prill 2005, ka realizuar të ardhura në total rreth 57.000 lekë).
- Vërtetim nr. *** prot., datë 4.4.2018, nga Enti Kombëtar i Banesave për Drita Ziu, e cila për periudhën janar 2008 - shtator 2017 ka realizuar të ardhura në shumën totale neto prej 5.473.348 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 26.12.2019, nga Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, për Drita Ziu, e cila për periudhën shtator 2017 - dhjetor 2018 ka realizuar të ardhura në shumën totale neto prej 906.325 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 22.6.2021, nga Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore për Drita Ziu, e cila për periudhën janar 2019 - 1 qershor 2021 ka realizuar të ardhura në shumën totale neto prej l. 677.586 lekë.
- Nxjerrje llogarie page në emër të Drita Ziu, pranë Raiffeisen Bank, gjatë periudhës 2.6.2021 - 31.12.2022.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrative

- **RFZ Bank** me shkresën nr.*** , dt. 8.5.2023, konfirmon llogarinë e pagës në emër të shtetases Drita Ziu dhe pagat e kreditura gjatë periudhës 4.5.2005 - 2.52008 dhe 3. 10. 2017 - 6.3.2023, në vlerën totale prej rreth 6.162.000 lekë.

- **Credins Bank** me shkresën nr.***, dt. 30.5.2023, konfirmon Ilogarinë e pagës në emër të Drita Ziu, dhe pagat e kredituara për periudhën 30.4.2008 - 29.9.2017, në vlerën totale prej 6.072.000 lekë.
- **ISSH** me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2023, konfirmon se Drita Ziu ka realizuar të ardhura gjatë periudhës: prill 2012 - tetor 2017 pranë Entit Kombëtar të Banesave; shtator 2017 - mars 2023 pranë Qendrës Kombëtare të Urgjencës mjekësore.
- ✓ ***Të ardhurat neto të bashkëshortes nga paga, shpërblimet, për periudhën 1993 mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 13.640.000 lekë.***

DEKLARIMI I DJALIT - GJERGJI ZIU

DEKLARIMI I PASURISË

- Pagar për blerje apartamenti me kontratë sipërmarrje nga shoqëria "Nderpro" shpk. Vlera 6.500.000 lekë. Zotëron 100%. Burimi i krijimit: kredi bankare në vlerën 4.456.850 lekë; të ardhurat e prindërve në vlerën 2.043.150 lekë.

Dokumentacioni bashkëlidhur

- Kontratë sipërmarrje për prenotim apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.12.2021, nënshkruar ndërmjet shoqërisë "Ndërpro " shpk dhe palës porositëse Gjergji Ziu, të një apartamenti me sip. 71.82 m2, ndodhur në Tiranë. Vlera e shitjes së apartamentit 7.500.000 lekë do të paguhet e plotë në Ilogarinë bankare të shoqërisë "Ndërpro " shpk, me këste si vijon; kësti i parë prej 4.500.000 lekë do të paguhet nëpërmjet kredisë bankare që do të përfitojë porositësi deri në datë 30.3.2022; kësti i dytë në shumën 2.000.000 lekë do të paguhet deri në datë 31.7.2022 dhe pjesa e mbetur prej 1.000.000 lekë do të paguhet me marrjen e apartamentit në dorëzim.
- Kontratë kredie nr. ***rep., nr. *** kol., datë 17.2.2022, nënshkruar pranë Bankës Kombëtare Tregtare nga pala kredimarrëse Gjergji Ziu dhe Marinela Ziu dhe pala dorëzanëse Drita Ziu. Objekti i kontratës është kreditimi në favor të kredimarrësit të shumës 4.456.850 lekë, me qëllim blerje shtëpie. Afati i shlyerjes së kredisë 300 muaj. Sigurimi i kredisë nga kredimarrësi dhe dorëzanësi, kundrejt kredisë së dhënë nga Banka do të kryhet nëpërmjet hipotekimit të pasurisë "apartament" me sip. 74.6 m2, e regjistruar me nr. Pasurie *****, në Tiranë, në pronësi të shtetasit Blerim Arapi.
- Nxjerrje Ilogarie në emër të Gjergji Ziu pranë BKT, gjatë periudhës 01.02.2022 - 31.12.2022, ku evidentohet disbursimi i kredisë me vlerë 4.456.850 lekë, në dt. 25.2.2022. Në dt. 01.03.2022 transferohet nga Ilogaria shuma 4.500.000 lekë, me përshkrim "Gjergji Ziu në favor të "Ndërpro " shpk., kalim për pagesë të kështit të parë të blerjes së apartamentit, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., dt. 30.12.2021".

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

- **BKT** me shkresën nr.***, dt. 9.5.2023, konfirmon Ilogari rrjedhëse në emër Gjergji Ziu, në të cilën në dt. 25.2.2022 është disbursuar kredia me vlerë 4.456.850 lekë. Në dt. 1.3.2022 është transferuar shuma 4.500.000 lekë nga Gjergji Ziu, në favor të "Nderpro " shpk, me përshkrim "kalim për pagesë të këstit të parë të blerjes së apartamentit, sipas kontratës së sipërmarrjes". Në dt. 4.8.2022 Gjergji Ziu depoziton cash shumën 625.000 lekë dhe po në të njëjtën ditë, transferon 600.000 lekë për "Nderpro " shpk, me përshkrim "kalim sipas kontratës së sipërmarrjes 2556 rep., nr. 115 kol., dt. 30.12.2021". Në dt. 2.12.2022, Gjergji Ziu depoziton cash shumën 540.000 lekë dhe po në të njëjtën ditë, transferon 500.000 lekë për "Nderpro " shpk, me përshkrim "pagesë kësti i tretë, sipas kontratës së sipërmarrjes 2556 rep., nr. 115 kol., dt. 30.12.2021".
- **RFZ Bank** me shkresën nr.***, dt. 8.5.2023, konfirmon se shtetasja Drita Ziu, ka pasur Ilogari investimi në Bono Thesari/Obligacioni, me vlerë 1.000.000 lekë. Data e investimit 20.08.2019, data e maturimit 20.08.2020. Investimi është kryer nga Ilogaria e pagës. Në datën 24.05.2022 është tërhequr cash nga Drita Ziu, shuma 950.000 lekë. Gjithashtu, në dt. 2.8.2022, Drita Ziu tërheq cash nga Ilogaria shumën 500.000 lekë.
- **Credins Bank** me shkresën nr. 21/10, dt. 30.5.2023, konfirmon depozitën në emër të Drita Ziu, me gjendje për periudhën 2018 — 2021, në vlerën 400.000 lekë dhe tërhequr cash në dt. 14.10.2022, në vlerën 408.300 lekë.
- **ASHK (online)**, Tirana Jug, Tiranë Veri, Kamëz Vorë, Rurale 1, Rurale 2, Zonave të Stimuluara nuk e konfirmojnë pasurinë të regjistruar në emër të Gjergji Ziu. Në proces-verbalin e datës 3.7.2023, subjekti sqaroi se në vlerën e deklaruar të apartamentit i është referuar vlerës së paguar realisht për të. Paraqiti:
- Vërtetim nga shoqëria "Nderpro " shpk, ku konfirmohet se shtetasi Gjergji Ziu ka lidhur një kontratë sipërmarrje nr. *** rep., nr. ***kol., datë 30.12.2021, për blerjen e një apartamenti. Deri ditën e lëshimit të vërtetimit, detyrimi i shtetasit Gjergji Ziu, për kompaninë e tyre, është në vlerën 1.000.000 lekë.
- Subjekti sqaroi se shuma e depozituar nga djali Gjergji Ziu, në dt. 2.12.2022, në Ilogarinë e tij në BKT, ka si burim financiar të ardhurat e familjes, konkretisht shumën 408.000 lekë të tërhequr nga Drita Ziu në dt. 14.10.2022 (prishje e depozitës dt. 14.10.2022) në Credins Bank dhe 132.000 lekë nga pagat e pa tërhequra në Raiffeisen Bank.
- Subjekti sqaroi se shtetasi Blerim Arapi është me profesion mjek, mik i familjes së tij prej vitesh dhe koleg me djalin e tij, i cili u vetëofrua dhe vendosi si garanci apartamentin e tij, deri sa të hipotekohet apartamenti i djalit të tij. Arsyeja që nuk u vendos apartamenti i tij si garanci është se në atë periudhë, por edhe sot, kërkon ta ndërrojë me një apartament tjetër.

Bazuar në deklarinë e subjektit, sqarimet dhe dokumentacionin e paraqitur, në mënyrë të përmbledhur rezulton se, Apartamenti me sip. 71.82 m², në Tiranë, në zotërim 100% të djalit të subjektit është përfituar me kontratë sipërmarrje dt. 30.12.2021, në vlerën 7.500.000 lekë, nga të cilat shlyer shuma 6.500.000 lekë, ndërsa diferenca 1.000.000 lekë është ende detyrim

financiar ndaj shoqërisë së ndërtimit, me burim financiar kredi bankare në BKT dhe të ardhurat e prindërve. Kredia bankare rreth 4.500.000 lekë, transferuar në dt. 1.3.2022, në favor të firmës, dhe diferenca 2.000.000 lekë depozituar cash në llogarinë bankare të Gjergji Ziu, janë tërhequr cash nga llogaritë/depozitat bankare në emër të nënës së tij Drita Ziu. Sipas sqarimeve të subjektit, apartamenti ende nuk ka përfunduar dhe djali nuk banon në të.

Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar, shpjegimet e dhëna dhe përgjigjet e institucioneve lidhur me apartamentin me sip. 71.82 na2 në' R". Mustafa Mara", Tiranë. Djali i subjektit ka likuiduar 6.500.000 lekë, detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë së ndërtimit "Nderpro" shpk. është 1.000.000 lekë.

- Llogari page në Credins Bank me gjendje në dt. 1.3.2023, në vlerën 1.284.827 lekë. Zotëron 100%. Burimi i krijimit: kursime nga pagat 2017-2023.

Dokumentacioni bashkëlidhur

- Nxjerrje llogarie në emër të Gjergji Ziu pranë Credins Bank, gjatë periudhës 3.1.2023 – 16.2.2023. Gjendje e llogarisë në dt 16.2.2023, në vlerën 1.284.826 lekë.
- **Credins Bank** me shkresën nr.***, dt. 30.5.2023, konfirmon llogari page në emër të Gjergji Ziu, me gjendje në dt. 08.03.2023, në vlerën 1.309.559 lekë. B/lidhur lëvizjet e llogarisë, ku evidentohet se llogaria është kredituar nga pagat, prej vitit 2017 të çeljes së llogarisë, ku gjendja fillestare e së cilës ishte akumuluar në vlerën 275.000 lekë, dt. 31.12.2017 dhe është shtuar ndër vite.

Konstatohet se llogaria është krijuar gjatë periudhës 2017 - 2023.

Djali deklaron gjendjen e llogarisë në Credins Bank, dt. 01.03.2023, ndërsa konfirmimi i bankës është i datës 08.03.2023.

- Llogari page në Tirana Bank, me gjendje në dt. 01.03.2023, në vlerën 701.188 lekë. Zotëron 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat nga bujqësia për periudhën 2018-2022.

Dokumentacioni bashkëlidhur

- Nxjerrje llogarie në emër të Gjergji Ziu, pranë Tirana Bank, gjatë periudhës 05. 01. 2022 - 31.12.2022. Gjendje e llogarisë në dt. 31.12.2022, në vlerën 701.638 lekë.
- **Tirana Bank** me shkresën nr.***, dt. 08.05.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të Gjergji Ziu, me gjendje në dt. 08.03.2023, në vlerën 701.188 lekë. B/lidhur lëvizjet e llogarisë, ku evidentohet se llogaria është çelur në vitin 2017 dhe është kredituar prej vitit 2018, nga likuidimet e faturave, ku gjendja fillestare e së cilës ishte akumuluar në vlerën 504.000 lekë, dt. 31.12.2018 dhe është shtuar ndër vite.

- Në dt. 28.01.2022 depoziton cash shumë 237.000 lekë, me përshkrim "të ardhura nga aktiviteti bujqësor fat. 644, 977, 978, 980, 981, 982, dt. 29.12.2021. Në proces-verbalin e datës 3.7.2023, subjekti paraqiti: Faturat nr. 10, 977, 978, 979, 980, 981, 982, 6/2021, lëshuar nga Gjergji Ziu, me vlerë totale 237.766 lekë.

Konstatohet se Ilogaria është krijuar gjatë periudhës 2018 - 2023. Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjiigien e Tirana Bank.

- Llogari e disbursimit dhe e shlyerjes së kredisë në BKT Tiranë, me gjendje në dt. 01.03.2023 në vlerën 87.697 lekë. Zotëron 100%. Bashkëlidhur deklaratës:
- Nxjerrje Ilogarie në emër të Gjergji Ziu, pranë BKT, gjatë periudhës 1.1.2023 L 3.2023. Gjendje e Ilogarisë në dt. 1.3.2023, në vlerën 87.697 lekë.
- **BKT** me shkresën nr. 21/3, dt. 9.5.2023, konfirmon Ilogarinë rrjedhëse në emër Gjergji Ziu dhe gjendjen në Ilogari, dt. 8.3.2023, në vlerën 86.393 lekë. Në dt. 7.2.2023, Gjergji Ziu depoziton cash shumë 120.000 lekë.
- Subjekti sqaroi se vlera e depozituar 120.000 lekë ka si burim të ardhurat e djalit nga puna, vlerë e tërhequr nga Ilogaria e tij në Credins Bank, dt 28.12.2022, shuma 200.000 lekë. Kjo vlerë ka shërbyer për shpenzime personale dhe shlyerjen e kësteve në vazhdim. Në kushtet që bashkëshortja është dorëzanëse në këtë kredi, këstet e kredisë shlyhen gjithashtu edhe nga kontributi i tyre familjar.
- Subjekti sqaroi se vlera e tërhequr cash prej 200.000 lekë, në dt. 28.12.2022, është përfshirë në gjendjen cash të familjes dhe nuk është deklaruar veçmas prej tij.

Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjiigien e BKT.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura nga paga pranë klinikës dentare "Yili Cika" për periudhën 2011 - 2022 dhe nga mësimdhënia në Fakultetin e Mjeksisë Dentare. Shuma e të ardhurave 1.905.708 lekë.
Të ardhurat nga shitja e prodhimeve bujqësore e blektorale, regjistruar si fermer nga viti 2019 e në vazhdim. Shuma e të ardhurave 1.059.390 lekë

Dokumentacioni bashkëlidhur

- Vërtetim dt. 27.12.2019, nga "Yili Cika" - Person Fizik, me NIPT K*****D, për Gjergji Ziu, i cili është i punësuar pranë këtij subjekti dhe, në bazë të listëpagesave të dorëzuara në organet tatimore, ka realizuar të ardhura për vitin 2017, në shumë 88.800 lekë dhe për vitin 2018, në total 266.400 lekë.

- Vërtetim dt. 21.6.2021, nga "Ylli Cika"- Person Fizik, me NIPT K*****D, për Gjergji Ziu, i cili është i punësuar pranë këtij subjekti dhe ka realizuar të ardhura neto për vitin 2019, shumën 277.056 lekë; për vitin 2020, shumën 332.198 lekë; për periudhën janar - maj 2021, shumën 190.050 lekë.
- Nxjerrje llogari page në emër të Gjergji Ziu, pranë Credins Bank, gjatë periudhës 20.01.2021 - 30.12.2021 dhe 19.01.2022 - 31.12.2022.
- Nxjerrje llogari page në emër të Gjergji Ziu, pranë Credins Bank, gjatë periudhës 20.1.2021 - 30.12.2021 dhe 19.1.2022 - 31.12.2022.
- Certifikatë regjistrimi personit të tatueshëm "Fermeri Gjergji Dhimitër Ziu " me NIPT L***** F, adresë Poshnje, Ura Vajgurore.
- Fatura tatimore shitje, lëshuar nga Gjergji Ziu, gjatë periudhës 2018 - 2022, vlerë totale 1.029.800 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

- **Tirana Bank** me shkresën nr. **** prot, dt. 8.5.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të Gjergji Ziu, në të cilën janë kredituar pagesa nga individ/subjekte tregtare, me burim aktivitetin tregtar si fermer dhe likuidimin e faturave. Për periudhën 2018-2022, janë kredituar gjithsej 1.018.000 lekë.
- **Credins Bank** me shkresën nr.***, dt 30.5.2023, konfirmon llogarinë e pagës në emër të Gjergji Ziu dhe të ardhurat e kredituara nga subjekti "Ylli Cika - Person Fizik", gjatë periudhës 9.3.2018 - 2.3.2023, në vlerën totale rreth 1.960.600 lekë.
- **ISSH** me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2023, konfirmon se Gjergji Ziu ka realizuar të ardhura gjatë periudhës: shtator 2017 - mars 2023, pranë subjektit "Ylli Cika ". Gjithashtu, në mars 2022 dhe shkurt 2023 ka përfutur të ardhura pranë Fakultetit të Mjekësisë Dentare.
- **D.P. Tatimeve** me shkresën nr. ** prot., datë 11.5.2023, konfirmon se shtetasi Gjergji Ziu, figuron i regjistruar pranë DRT Berat, si "Fermeri Gjergji Ziu " me NIPT L*****F.
- **DRT Berat** me shkresën nr. ***prot., datë 5.5.2023, konfirmon se shtetasi Gjergji Ziu, figuron i regjistruar si prodhues bujqësor (fermer), me NIPT*****, nga data 24.10.2017. Statusi aktual "aktiv ". Nuk ka përgjegjësinë për deklaram për xhiro vjetore deri në 10 milion lekë. Për periudhën 24.10.2017 - 3.5.2023 ka realizuar një xhiro prej 239.520 lekë.

Dokumentacioni i administruar:

- Kontratë huapërdorje e pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. **** kol., datë 15.9.2017, nënshkruar ndërmjet palës huadhënëse Dhimitraq Ziu e Drita Ziu dhe palës huapërdoruese Gjergji Ziu, të pasurive nr. *****, lloji "Ullishte" me sip. 1.450 m2, nr. *** lloji "Arë" me sip. 6.500 m2, nr. **** lloji "Arë" me sip. 1.000 m2, ndodhur në Berat. Afati i dhënies në

huapërdorje të pronës është tre vjeçar, afat i cili ka filluar në 15.9.2017 dhe përfundon në 15.9.2020, me të drejtë ripërtëritje. Destinacioni i dhënies në huapërdorje të këtyre pronave është përdorimi nga ana e huapërdoruesit për të ushtruar aktivitetin e fermerit. Palët kanë rënë dakort që kontrata e huapërdorjes të lidhet pa kundërshtpërblim.

- Subjekti sqaroi se në vlerën e deklaruar të të ardhurave nga shitja e prodhimeve bujqësore e blektorale, djali i është referuar vlerës totale të faturuar si fermer, në shumën l. 088.646 lekë, vlerë kjo e llogaritur, pasi ka përfshirë edhe faturën nr. 980, me vlerë 29.256 lekë (faturë e papërfshirë në llogaritjen e deklaruar fillimisht nga djali). Paraqiti:
- Tabelë përmbledhëse të vlerës totale të faturuar dhe deklaruar (tabelë e plotësuar nga subjekti).
- Subjekti paraqiti Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 6.7.2023, nga DRT Berat, drejtuar Fermer "Gjergji Ziu", me NIPT L*****F, në lidhje me qarkullimin e realizuar nga ky subjekt gjatë viteve 2017 - 2022, në total 1.229.388 lekë.

Të ardhurat neto të djalit nga paga, për periudhën mars 2018 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 1.960.000 lekë.

Të ardhurat e djalit nga aktiviteti bujqësor (qarkullimi), për periudhën 2017- mars 2023, konfirmohen nga DRT Berat, në vlerën totale prej 239.520 lekë, ndërsa nga subjekti dokumentohen në vlerën totale rreth 1.229.000 lekë, me shkresë po nga DRT Berat.

DETYRIMET FINANCIARE

- Kredi bankare në BKT, në shumën 4.456.850 lekë. Detyrimi financiar në dt. 1.3.2023, në vlerën 4.332.292 lekë.

BKT me shkresën nr. 21/3, dt. 9.5.2023, konfirmon kredinë në emër Gjergji Ziu dhe detyrimin financiar dt 08.03.2023, në vlerën 4.332.291 lekë.

✓ ***Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e BKT.***

- Detyrim ndaj shoqërisë "Nderpro shpk" për blerje apartamenti, në vlerën 1.000.000 lekë.

Trajtuar më lart.

DEKLARIMI I VAJZËS - MARINELA ZIU

DEKLARIMI 1 PASURISË

- Llogari page në BKT, me gjendje në dt. 1.3.2023, në vlerën 142.950 lekë. Zotëron 100%. Burimi i krijimit: kursimet nga paga 2022.

 **Dokumentacioni bashkëlidhur**

- Nxjerrje e llogarisë në emër të Marinela Ziu, pranë Credins Bank, gjatë periudhës 1.1.2023 - 28.2.2023. Gjendje në llogari dt. 6.3.2023, në vlerën 142.950 lekë. Evidentohet depozitimi cash në datë 9.2.2023, në vlerën 100.000 lekë, si dhe kreditimi i pagës në dt. 28.2.2023, në vlerën 43.100 lekë.
- Mandat depozitimi bankar dt. 9.2.2023 në BKT, Marinela Ziu depoziton shumën 100.000 lekë.

BKT me shkresën nr. 21/3, dt. 9.5.2023, konfirmon llogarinë rrjedhëse në emër të Marinela Ziu dhe gjendjen në llogari dt. 8.3.2023, në vlerën 142.950 lekë.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e BKT.**
- Depozitë në Credins Bank, krijuar në vitin 2013, në shumën 127.000 lekë me gjendje në dt. 9.2.2023, në vlerën 140.774 lekë. Zotëron 100%.
Burimi i krijimit: shpërblimet nga Bashkia Tiranë 27.000 lekë, kursimet e familjes ndër vite.

Dokumentacioni bashkëlidhur

- Nxjerrja e llogarisë në emër të Marinela Ziu, pranë Credins Bank, gjatë periudhës 31.12.2021 - 6.10.2022. Gjendje në llogari dt. 6.10.2022, në vlerën 140.774 lekë.

Credins Bank me shkresën nr. 21/10, dt. 30.5.2023, konfirmon depozitën në emër të Marinela Ziu, me gjendje në dt. 8.3.2023, në vlerën 140.774 lekë. Evidentohet se depozita është çelur në vitin 2013, me urdhërxhirim në vlerën 27.000 lekë, dt. 6.4.2013, nga llogaria rrjedhëse e Marinela Ziu, në të cilën janë kredituar pagesat nga Shkolla "Sabaudin Gabrani", si dhe nga transferta dt. 6.4.2013, në shumën 100.000 lekë, nga llogaria e Drita Ziu.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e Credins Bank.**
- Llogari page në OTP Bank, me gjendje në dt. 1.3.2023, në vlerën 586 lekë. Zotëron 100%.

Dokumentacioni bashkëlidhur

- Nxjerrje e llogarisë në emër të Marinela Ziu, pranë OTP Bank, gjatë periudhës 23.2.2022 - 28.2.2023. Gjendje në llogari dt. 1.3.2023, në vlerën 586 lekë.
- Mandat tërheqje bankare dt. 9.2.2023, në BKT, Marinela Ziu tërheq shumën 110.000 lekë.

OTP Bank me shkresën nr. **, cit. 5.5.2023, konfirmon se Marinela Ziu disponon llogari me gjendje, në dt. 8.3.2023, në vlerën 586 lekë.**

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e OTP Bank.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura nga paga në klinikën dentare "Belle Vue" për periudhën mars 2022 - janar 2023. Shuma e të ardhurave 325.768 lekë.
- Të ardhurat nga paga në Klinikën Dentare Elite, shkurt 2023. Shuma e të ardhurave 43.100 lekë.

Dokumentacioni bashkëlidhur

- Nxjerrje e llogarisë në emër të Marinela Ziu, pranë OTP Bank, gjatë periudhës 23.2.2022 - 28.2.2023, në të cilën janë kredituar paga, nga subjekti Bellevue, në total 327.768 lekë.
- Nxjerrje e llogarisë në emër të Marinela Ziu, pranë Credins Bank, gjatë periudhës 1.1.2023 - 28.2.2023, në të cilën është kredituar nga Etleva Dema, Person Fizik, paga e muajit shkurt, në vlerën 43.100 lekë.
- **BKT** me shkresën nr. 21/3, dt. 9.5.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të Marinela Ziu, në të cilën në dt. 28.2.2023, është kredituar shuma 43.100 lekë nga Etleva Dema, Person Fizik, me përshkrimin "paga shkurt".
- **OTP Bank** me shkresën nr. 21/12, dt. 5.5.2023, konfirmon të ardhurat e kredituara në llogarinë e pagës në emër të Marinela Ziu, gjatë periudhës prill 2022 - shkurt 2023, në vlerën totale 325.768 lekë.
- **ISSH** me shkresën nr. 21/30 prot., datë 12.5.2023, konfirmon se Marinela Ziu ka realizuar të ardhura gjatë periudhës: shkurt 2022 - janar 2023, pranë subjektit "BelleVue" dhe në shkurt - mars 2023, pranë subjektit "Etleva Dema".

Në mënyrë të përmbledhur, referuar të dhënave të deklaratës së pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti dhe personat e lidhur me të; kanë deklaruar deri në datë 8.3.2023, si më poshtë:

1. Godinë + truall, me sip. 29.6 m², nr. pasurie 15/8 ndodhur në lagjen Vjetori" Berat, ndërtuar në Vitin 1998. Vlera 521.600 lekë. Zotëron 100% me bashkëshorten.
2. Njësi tregtare me sip. 13.7 m², ndodhur në lagjen "30 Vjetori" Berat, Vlera 10.000 lekë. Zotëron 100% me bashkëshorten.
3. Njësi tregtare me sip. 14.8 m², ndodhur në lagjen "30 Vjetori" Berat. Vlera 10.000 lekë. Zotëron 100% me bashkëshorten.
4. Tokë arë + truall me sip. 700 m² (200 m² trualli) dhe ndërtesë me sip. 100 m², në Poshnje, Berat. Përfitur nga babai me AMTP. Vlera e investuar 933.000 lekë. Zotëron 100 % me bashkëshorten.

5. Apartament banimi me sip. 99.22 m2, ndodhur në rrugën e "Kavajës", Tiranë. Blerë në vitin 2005. Vlera 49.320 euro. Zotëron 100 % me bashkëshorten.
6. Tokë arë 6.500 m2, nr. pasurie 335/1 Poshnjë, Berat. Burimi i krijimit: përfituar nga familja me ligjin 7501 dhe përpjestimi vullnetar i pasurisë. Vlerë 0 lekë. Zotëron 100% me bashkëshorten.
7. Tokë arë 1.500 m2, nr. pasurie 9/33, Poshnjë, Berat. Përfituar si dhuratë nga prindërit. Vlerë 0 lekë. Zotëron 100%.
8. Ullishte 1.450 m2, nr. pasurie 887/170 Poshnjë, Berat. Burimi i krijimit: përfituar nga familja me ligjin 7501 dhe përpjesëtimi vullnetar i pasurisë. Vlerë 0 lekë. Zotëron 100% me bashkëshorten.
9. Tokë arë 1.000 m2, nr. pasurie 335/5 Poshnjë, Berat. Burimi i krijimit: përfituar nga familja me ligjin 7501 dhe përpjestimi vullnetar i pasurisë. Vlerë 0 lekë. Zotëron 10% me bashkëshorten.
10. Tokë arë 160 m2, nr. pasurie 337/5 Poshnjë, Berat. Burimi i krijimit: përfituar nga familja me ligjin 7501 dhe përpjestimi vullnetar i pasurisë. Vlerë 0 lekë. Zotëron 100% me bashkëshorten.
11. Automjet Mercedes Benz me targë AB897FM, vit prodhimi 2013. Vlerë 1.690.000 lekë. Zotëron 100% me djalin.
12. Gjendje cash 900.000 lekë. Zotëron 100% me bashkëshorten.
13. Llogari në ISP Bank. Vlerë 1.000.000 lekë. Zotëron 100%.
14. Llogari page në Tirana Bank. Vlerë 1.420.804 lekë. Zotëron 100%.
15. B/shortja: Llogari page në Raiffeisen Bank. Vlerë 1.857.289 lekë. Zotëron 100%.
16. B/shortja: Depozitë me afat në Credins Bank, mbyllur dhe tërhequr e gjithë. Vlerë 0 lekë.
17. B/shortja: Fond pensioni "Sicred Pensions". Vlerë 36.916 lekë. Zotëron 100%.
18. Djali: Apartament me sip. 71.82 m2 në Tiranë, blerë me kontratë sipërmarrje. Vlerë 7.500.000 lekë. Zotëron 100%.
19. Djali: Llogari page në Credins Bank. Vlerë 1.284.827 lekë. Zotëron 100 %.
21. Djali: Llogari e shlyerjes së kredisë në BKT Tiranë. Vlerë 87.697 lekë. Zotëron 100%.
22. Vajza: Llogari page në BKT. Vlerë 142.950 lekë. Zotëron 100%.
23. Vajza: Depozitë në Credins Bank. Vlerën 140.774 lekë. Zotëron 100 %.
24. Vajza: Llogari page në OTP Bank. Vlerën 586 lekë. Zotëron 100%.
25. Djali: Kredi bankare në BKT në shumën 4.456.850 lekë. Detyrimi financiar në vlerën 4.332.292 lekë. Zotëron 100%.
26. Djali: Detyrim ndaj shoqërisë "Nderpro shpk" për blerje apartamenti, në vlerën 1.000.000 lekë. Zotëron 100%.

Vlera e pasurisë bruto është 18.237.631 lekë + 49.320 Euro, e konvertuar rreth 23.906.000 lekë dhe neto rreth 18.574.000 lekë.

Detyrimet financiare janë në vlerën totale rreth 5.332.000 lekë (nga të cilat ndaj BKT në vlerën rreth 4.332.000 lekë dhe ndaj shoqërisë Nderpro në vlerën 1.000.000 lekë). (Konvertuar me kursin e këmbimit të BSH të datës 8.3.2023, ku 1 Euro 114.94 lekë).

Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesave, u bë analiza e të dhënave të deklaruara nga subjekti me informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, proces nga i cili, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se:

- ✓ Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, pasuria totale deri në datë 8.3.2023, është deklaruar 18.237.631 lekë + 49.320 Euro, e konvertuar bruto rreth 23.906.000 lekë dhe neto rreth 18.574.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat neto të subjektit nga paga, shpërblimet, për periudhën 1986 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 22.760.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat neto të bashkëshortes nga paga, shpërblimet, për periudhën 1993 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 13.640.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat neto të djalit nga paga, për periudhën mars 2018 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 1.960.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat neto të vajzës nga paga, për periudhën shkurt 2022 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 369.000 lekë.
- ✓ Të ardhura nga bujqësia dhe blegtoia për periudhën 1991 - 2018 janë deklaruar në vlerën totale 4.300.000 lekë (vlerë e padokumentuar dhe e pakonfirmuar nga institucionet përkatëse tatimore).
- ✓ Të ardhura (xhiro) të djalit nga aktiviteti si fermer me NIPT 19342413 IF, për periudhën 2017 - mars 2023, janë deklaruar në vlerën 1.089.000 lekë.

Gjithashtu, janë deklaruar:

- Kredi bankare në BKT, për blerjen e apartamentit në emër të djalit, në Tiranë, v.2022 në shumën 4.456.850 lekë. Detyrimi i mbetur 4.332.292 lekë.
- Detyrim shoqërisë sipërmarrëse për blerjen e apartamentit në emër të djalit në Tiranë v.2022, në vlerën 1.000.000 lekë. Detyrimi i mbetur 1.000.000 lekë.
- Huamarrje shtetasit S. Bode 4.900.000 lekë, për blerjen e apartamentit në Tiranë v. 2004. (Shlyer gjatë periudhës 2006 — 2015).
- Të ardhura neto nga shitje/blerje e apartamentit/njesisë me sip. 65.5 m², në Berat, në v. 2005, në vlerën rreth 800.000 lekë. (blerë 200.000 lekë, shitur 1.000.000 lekë).
- Të ardhura nga qiradhënia e pasurive të paluajtshme në Berat, në periudhën 1999 — 2023, në vlerën totale 6.220.000 lekë.

- ✓ Për periudhën janar 2000 - mars 2023, referuar treguesve statistikorë të INSTAT, janë shpenzuar minimalisht për konsum personal (familjar), rreth 15.750.000 lekë.
- ✓ Për periudhën janar 2000 - mars 2023, janë shpenzuar për mobilim, në total rreth 700.000 lekë. Gjithashtu janë shpenzuar për blerjen e pjesës takuese të prindërve në apartamentin në Berat dhe adaptimin e tij në 3 njësi, janë në vlerën totale prej rreth 237.000 lekë.
- ✓ Për periudhën 1.1.2022 — 31.12.2022, janë shpenzuar për ujë, drita, telefon dhe internet etj në total rreth 250.000 lekë.
- ✓ Për periudhën 1.1.2022 — 31.12.2022, janë shpenzuar për udhëtime të subjektit dhe familjarëve, në total 720 euro, konvertuar rreth 83.000 lekë.
- ✓ Për periudhën deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, janë shpenzuar për arsimimin e personave të lidhur, në total **43.900 euro**, konvertuar rreth 5.000.000 lekë.

Të ardhurat neto të vaizës nga paga, për periudhën shkurt 2022 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 369.000 lekë.

- ✓ ***Në konkluzion për vlerësimin e pasurisë, në përputhje me pikën 6 të nenit 34 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:***
 - a) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe se punonjësi nuk gjendet në situatë konflikti interesi;***
 - b) nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;***
 - c) nuk është kryer fshehje e pasurisë;***
 - ç) nuk është kryer deklarim i rremë;***
 - d) punonjësi nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit***

B. KONTROLLI I FIGURËS

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

 Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre elementë:

1. të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;

2. raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
3. verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, gërma (ë), e ligjit 12/2018, i ndryshuar.

 **TRUPA E VLERËSIMIT**, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të vlerësimit Z. Dhimitraq Ziu, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikimit nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.

 **Për kontrollin e figurës, TRUPA E VLERËSIMIT administroi:**

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”.
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
- c. Korrespondencën me institucionet ligjzbatuese.

Në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse, rezulton se:

- **Nuk ka** ndryshim të gjeneraliteteve të subjektit të vlerësimit.
- Subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk rezultojnë të dënuar.
- **Nuk ka** të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtëpërdrejtë ose indirect në veprime të dyshimta.
- **Nuk ka** të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”), ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj.
- **Nuk ka** të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (persona të dënuar apo proceduar penalisht, Brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10 192 datë 30.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar).
- **Nuk ka** të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale.
- **Nuk ka** të dhëna nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale.

- **Nuk ka** të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhëri ndërkombëtar, për kryerje e një veprë penale.
- **Nuk ka** të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- **Nuk ka** të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundërligjshëm
- **Nuk ka** procedime penale të referuara
- Për subjektin e vlerësimit **nuk disponohen** ankesa, të dhëna ose informacione që lidhen me objektin e kërkesës.
- **Nuk është** nxjerë urdhër ndalimi
- **Nuk është** kërkuar masë e sigurimit personal
- **Nuk është** marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit në hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale
- **Nuk ka pasur** regjistrim të njoftimit të veprave penale
- **Nuk ka pasur** raste të urdhrave ndërkombëtare të ndalimit.
- **Nuk rezulton** të jetë regjistruar ndonjë procedim penal për subjektin apo personat e lidhur me të.
- Është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”, me datë lëshimi 17.05.2023, të vlefshme deri më datë 16.05.2028. për subjektin e vlerësimit nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP-së.
- nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera.
- Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.
- Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri më 2 Korrik 1991.

Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se subjekti vlerësimit **Z Dhimitraq Jorgaq Ziu:**

Në përfundim të testit, sipas ekzaminimit toksikologjiko-ligjor nr. 99 të ardhur nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, me shkresë nr. 264/2 prot., datë 11.01.2023, jemi bërë me dije se:

“Në mostrën e marrë subjektit **nuk u zbulua** prania e produkteve të lëndëve narkotike të grupit të MOP (opiate/heroinë), COC (cocaine), MTD (metadon), THC (canabinoide/cannabis sativa), BARB (barbiturate), TCA (triciklike antidepressante), AMP (amphetamine), MDMA (ekstazi), LSD (acid lisergjik), BZO (benzodiazepine).

✓ ***Në konkluzion për vlerësimin e figurës, në përputhje me pikën 3 të nenit 42 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:***

a) punonjësi nuk ka kryer deklaram të rremë;

b) nuk ka informacione, të dhëna të vërtetuara nga agjencitë ligjzbatuese që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar;

c) nuk ka informacion në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj, që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
- raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standartet profesionale në Policinë e Shtetit/Gardën e Republikës/Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit 12/2018, i ndryshuar.

Subjekti i vlerësimit **Z. Dhimitraq Ziu** në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e Drejtorit në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër sipas urdhërit nr. 2072, datë 28.09.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet, sipas përcaktimeve të nenit 44 pika 2 dhe 3 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.

Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në:

- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit me Nr 18159;
- Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, sistemi RMIS, me Nr RMIS 9004372;
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të Nenit 44, pika 1, Ligjit Nr. 12/2018 , i ndryshuar, të mbështetuar në dokumentacionin shoqërues.
- Të dhënat e siguruara nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi Performancën e subjektit.

Nga shqyrtimi dhe analizimi i të burimeve të mësipërme, konstatohet si më poshtë vijon:

TË DHËNA MBI ARSIMIMIN

- Ka përfunduar arsimin e lartë në Akademinë e Policisë , në periudhat 1990-1993 diplomuar më 15.03.1995 me diplomën “Seria b”, Nr. Regjistri 123 dhe 1995-1999, diplomuar më 25.07.1999 me Diplomën “Nr-502-B”, nr. Regjistri 1372.

Sa më sipër, subjekti përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që kryen, sipas përcaktimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

TRAJNIMET DHE KUALIFIKIMET

Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit, rezulton se ka kryer trajnimet dhe specializimet si me poshtë:

1. Viti 2004 - kurs trajnimi për njohuritë bazë të kompjuterit, pajisur me certifikatë.
2. Viti 2014 – kurs për ngritjen në gradën drejtues.
3. Viti 2000- kurs “ Trajnimi i policëve supervizorë”, pajisur me certifikatë.
4. Viti 1999 – trajnim mbi policinë kriminale, pajisur me certifikatë.
5. Viti 2001- trajnim i trajnerëve të policisë, pajisur me certifikatë.
6. Viti 2001- trajnim për trajner i rezervuar për oficerët e Policisë Gjyqësore, pajisur me certifikatë.
7. Viti 2002- trajnim mbi luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe dhunës gjinore, pajisur me certifikatë.
8. Viti 2002- ligji dhe praktikat e azilit; prespektiva shqipare dhe ndërkombëtare.
9. Viti 2005 – trajnim për trajnues të formimit profesional të Policisë së Shtetit, në rolin bazë.
10. Viti 2004 – atributet e Policisë Gjyqësore dhe procedurat e përzgjedhjes.
11. Viti 2009 – Kursi i menaxhimit të incidenteve e krizave.
12. Viti 2009 – Kurs për menaxhimin e incidenteve e krizave lidhur me (ASHM) armët e shkatërrimit në masë.
13. Viti 2004 – Kurs për bazat kryesore të drejtuesve (lidërshipt) në rëndësinë e etikës.
14. Viti 2004 – Trajnim për trajnues të formimit profesional të punonjësit të policisë së shtetit, rolin bazë.
15. Viti 2010 – Kurs trajnimi për forcat speciale.
16. Viti 2012 – Menaxhimi i krizave në Greqi.
17. Viti 2013 – Kurs mbi parandalimin e falsifikimit të pasaportave. ILEA HUNGARI.
18. Viti 2006 – Trajnim mbi njohjen dhe përdorimin e sistemit të pasaportave.
19. Viti 2011 – Mbrojtja e të dhënave me standardet Europiane.
20. Viti 2016 – Sigurim fizik i objekteve shtet dhe private, aktiviteteve sportive dhe vlerave monetare.
21. Viti 2005 – Kurs mbi investigimin e krimeve.
22. Viti 2017 – Prespektiva gjinore në policim.
23. Viti 2014 – Në njohje të kontributit tuaj në kryerjen me sukses të vetëdijëzimit të drogës.

Gjithashtu, gjatë karrierës rezulton se subjekti ka marrë 1 medalje nderi dhe 1 Certifikatë për performancë të lartë në realizimin e detyrave e konkretisht:

1. Viti 2019 – Medalje Nderi

2. Viti 2022 – Certifikatë për Shërbime të Dalluara.

VLERËSIMET E PUNËS

Në dosjen personale të subjektit të vlerësimit, për periudhën 2018-2023, rezulton se janë të administruara 3 (tre) vlerësime të aftësive individuale të punës në të cilat është vlerësuar si vijon:

- **Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2018 26 pikë (shumë mirë)**
- **Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2019 28 pikë (shumë mirë)**
- **Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020 28 pikë (shumë mirë)**
- **Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021 28 pikë (shumë mirë)**

Në vlerësimet e mësipërme vlen të theksojmë se në periudhën 2018-2021, vlerësimi maksimal i punonjësve sipas formularit të vlerësimit ishte 28 pikë, ndërkohë nga viti 2022 e në vazhdim vlerësimi maksimal është 100 pikë.

Vlerësimi i aftësive individuale të punës sipas standardeve të përcaktuara bëhet nga eprori i drejtëpërdrejtë, bazuar në vlerësimin e integritetit, profesionalizmit, komunikimit, qëndrimit konstruktiv, paanshmërisë, punës në grup si dhe planifikimi dhe organizimit të punës.

Bazuar në sa vlerësimet e mësipërme të administruara në dosjen personale të punonjësit, konkludohet se subjekti ka përmbushur detyrat profesionale, ka respektuar rregullat e etikës si edhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.

MASAT DISIPLINORE

Nga verifikimi i dosjes personale dhe sistemit RMIS, nuk rezulton të ketë masë administrative në fuqi sipas legjislacionit përkatës.

ECURIA NË KARRIERË

Subjekti Dhimitraq Ziu, ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej 37 vitesh e 4 muaj. Nga verifikimi rezulton se gjatë periudhës 5 vjeçare objekt deklarimi, subjekti Dhimitraq Ziu ka ecurinë si më poshtë vijon:

- 01.10.2022 – Aktualisht, mban detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër.
- 28.10.2021 – 30.09.2022, ka ushtruar detyrën si Zëvendësdyrëtor për Sigurinë Publike dhe Policimin në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës.
- 06.07.2021 – 27.10.2021, ka ushtruar detyrën si Drejtor i Policisë Rrugore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- 10.02.2016 – 05.07.2021, ka ushtruar detyrën si Zëvendësdyrëtor për Sigurinë Publike dhe Policimin në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë.

Subjekti i Vlerësimit, Z. Dhimitraq Ziu, aktualisht mban gradën Drejtues i Parë sipas Urdhërit Nr. 3856 datë 30.12.2014.

Në përfundim, në lidhje me ecurinë në karrierë të subjektit të vlerësimit, Z. Dhimitraq Ziu, arrihet në konkluzionin se funksionet që ka ushtruar ndër vite janë në përputhje me ecurinë në gradë dhe në zbatim të legjislacionit rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

PJESËMARRJA NË KONFERENCA SHKENCORE, ËORKSHOP-E, SEMINARE, BOTIME BRENDA DHE JASHTË VENDIT.

Z. Dhimitraq Ziu, në formularin e aftësive profesionale për vlerësimin kalimtar, ka deklaruar se për periudhën objekt vlerësimi, është angazhuar si më poshtë vijon:

- 11 Tetor – 16 Tetor 2021 vizitë studimore në Republikën Çeke për sigurinë rrugore.
- ✓ *Në konkluzion për vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me pikën 1 të nenit 47 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:*

a) është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;

b) ka vlerësime pozitive pune;

c) ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban.

V. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i vlerësimit **Z. Dhimitraq Ziu**, në përputhje me nenin 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë,
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës,
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në bazë të germës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit **Dhimitraq Jorgaq Ziu**, me funksion Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër.

2. Vendimi i arsyetuar me shkrim, u njoftohet Subjektit të Vlerësimit si edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga data e nesërme e shpalljes së Vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikqyrjes Policore, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall sot datë 30.05.2024, në Tiranë.

TRUPA E VLERËSIMIT

Loreta HANXHARI

Kryesuese

Bora VRENJO

Relatore

Henri NAQELLARI

Anëtar